



**PROJEKTI I ZBATIMIT PER NDERTIMIN E
HIDROCENTRALIT
" CERENEC"**

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS**

PERGATITUR NGA:

"TAULANT" sh.p.k.
QKL, LN-7574-03-2014pk
Eksperte mjedisi:
Ditika Qatipi
Erjona Qatipi
Bashkepunim me, "EBS" sh.p.k.
Ing.Hidroteknik Fahri MAHQ
Msc.Ing.Mjedisi Nelisa HAXHI

POROSITESI:

"RAJFI" shpk

TIRANE, 2018

PERMBAJTJA E RAPORTIT

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI.....	17
2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI	22
3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR.....	24
4. PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE	37
5. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA	37
6. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË.....	38
7. MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN.....	39
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGJEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	42
9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË)	49
10. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË	50

Lista e Figurave

Figura 1: Largesia e zones se projektit nga Zonat e mbrojtura me te aferta.....	21
Figura 2: Foto nga mbulesa bimore e siperfaqes ku do te zbatohet projekti.....	22
Figura 3: Kurba e qendrueshmerise se prurjeve ditore per vitin mesatar me siguri 75% , 50% dhe 25 % ne aksin e veprave te marjes Hec “Cerenec”	23

Lista e Tabelave

Tabela 1: Ndotjet me te rendesishme te shkaktuara nga projekti.....	37
Tabela 2: Volumet e germimeve per Hec-in Cerenec	39
Tabela 3: Tabela e volumeve dhe siperfaqeve te depozitimit te inerteve per Hec-in Cerenec	40
Tabela 4: Tabele e permbledhur e masave zbutese te ndikimeve kryesore.....	46
Tabela 5: Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis te aktivitetit	48



PARATHENIE

Hartimi i vlerësimit paraprak te VNM- së, është kryer në bazë të ligjit: **10440 datë 07.07.2011** "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis",**neni 8, Shtojca II** (Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis), **pika 3** (industria e energjisë), **germa (ë)** (instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike), **ligjet nr.12/2015 Per disa ndryshime ne ligjin (e sipercituar) nr.10440 datë 07.07.2011 si dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015** "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore" dhe **Vendimit nr. 95, datë 14.02.2018** "Për disa shtesa dhe ndryshime tek VKM nr. 686, datë 29.07.2015"



HYRJE

Ky raport permban Vleresimin e Ndkimit ne Mjedis per projektin e Hidrocentralit "CERENEC", prej te cilit do te kemi nje shfrytezim racional dhe me tregues te vlefshem tekniko-ekonomike dhe energo-ekonomike.

Projektet e hidrocentraleve te cilat hyjne ne kategorine e projekteve per shfrytezimin e energjise se rinovueshme, sigurojne perfitime te konsiderueshme ekonomike dhe jane miqesore me mjedisin.

Projekti perputhet me objektivat e strategjisë se qeverise Shqiptare per shtimin e burimeve te prodhimit te energjise, me qellim permiresimin e gjendjes shoqerore dhe ekonomike, duke siguruar ne te njejten kohe ruajtjen e mjedisit, duke hequr menjane impaktet specifike qe mund te kete ne zonen ku ndertohet impianti i shfrytezimit te kesaj energjie.

Gjate hartimit te ketij rapporti te vleresimit te ndikimit ne mjedis, u konsultuan eksperte te mbrojtjes se mjedisit, eksperte te mbrojtjes se pyjeve, eksperte te flores dhe faunes, eksperte te vleresimit te ndikimit ne mjedis si dhe vendimarres te fushes.

Shqiperia eshte pale e nje numri Konventash Nderkombetare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj) dhe tashme ka nje pakete te plete ligjore per masat mbrojtse te mjedisit dhe vleresimin e impaktit ambiental te veprimtarive, sherbimeve apo ndertimeve ne mjedisin vepruesh.

Vendi yne duke qene anetar i nje numri konventash, detyrohet te zbatoje nje sistem sa me efektiv ekonomik social-mjedisor, per rregullimin e territorit, sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Shfrytezimi i baseneve ujembajtes ka cuar ne disa raste ne prishjen e ekuilibrave natyrore, per shkak te nje shfrytezimi pa kriter dhe pa rregulla sipas nje ligjshmerie te caktuar shkencore.

Per kete qellim nderhyrja, me synim shfrytezimin e prurjes mesatare per prodhimin e energjise, duhet koordinuar me aktivitete te tjera jetesore dhe ekonomike te zones.

Vemendje e vecante duhet te kete sidomos:

- kur keto basene jane afer qendrave te banuara
- kur nga keto basene furnizohet pjesa e madhe e fshatrave perreth, per popullsine dhe aktivitetet ekonomike poshte rrjedhes se lumiut, duke filluar nga vendi i ndertimit te HC
- kur ka objekte industriale qe jane te lidhur me nevojat per uje teknologjik
- kur zhvillohen aktivitete te akuakultures
- kur jane zona qe kane nje status te vecante, etj

Vleresimi i Ndkimit ne Mjedis (VNM) eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, perpara dhe gjate zbatimit te tij. VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrjes ne konsiderate te ceshtjeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.



- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Nxjerjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.

➤ PERSHKRIMI I QELLIMIT DHE OBJEKTIVAT E VNM

Procesi i hartimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), ndihmon ne permiresimin e çdo lloj projekti ne respektimin dhe mbrojtjen maksimale te mjedisit te zones ku ai zbatohet.

Qellimi i VNM-se eshte qe te siguroje qe mjedisi ne zonen ku zbatohet projekti do te konsiderohet i lidhur me gjithe çeshtjet e tjera te rendesishme, ne çdo etape te tij.

Ky raport eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe ka per qellim te identifikoje, parashikoje dhe vleresoje gjithe ndikimet e mundshme ne menyre sistematike, te kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja eshte vleresimi mjedisor ne nje proces vleresimesh (te mjedisit, planifikimit hapesinor, ndertimit, etj.) qe eventualisht mund te finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne fakt i pergjigjet ne thelb ketyre pyetjeve kyç:

- A. Si do te ishte mjedisi pa projektin?** (per shembull Studimet Baze). Kjo do te identifikoje dhe pershkruaje gjendjen aktuale te burimeve dhe karakteristikat ekzistuese ne mjedisin qe mund te ndikohet nga projekti dhe se si keto do te zhvillohen ne mungese te projektit.
- B. Çfare do t'i ndodhe mjedisit, si pasoje e projektit?** (per shembull Parashikimi). Kjo do te pershkruaje mjedisin siç eshte pa projektin dhe se si ai do te ndryshoje si pasoje e projektit ne aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) qe jane te ndikuar, natyren dhe shkallen e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.
- C. A perben kjo nje shqetesim?** (per shembull Vleresimi) Parashikimi i ndikimit nuk eshte i mjaftueshem.

Nese eshte i rendesishem a mund te bejme ndonje gje ne lidhje me te?(per shembull Zbutja). Se fundi, eshte e rendesishme te kuptohet se, ne qofte se ndikimi eshte i rendesishem, mund te behet diçka per te shmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar per te. Zhvilluesi i projektit mund t'i perfshije keto masa zbutese ne propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i perfshije kerkesat perkatese ne kushtet e lejes se dhene.

Ne menyre qe autoritetet kompetente dhe palet e jashtme te interesuara te vendosin nese projekti duhet te vazhdoje, eshte thelbesore qe informacioni mjedisor i dhene nga zhvilluesi ne Raportin e VNM-se, t'i pergjigjet ne menyre te qarte pyetjeve te mesiperme. Qellimi i studimeve te VNM eshte qe te gjeneroje dhe paraqese kete informacion nemenyre te qarte, koherente dhe te sakte.

Idea e VNM-se eshte te siguroje informacion per vendim marresit dhe publikun mbi pasojat mjedisor te zhvillimeve te reja te propozuara. Per me teper ideja eshte qe te promovohet zhvillimi qe respekton mjedisin permes identifikimit te masave te duhura forcuese dhe zbutese.



Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikoje ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-se kerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre eficiente;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- te vendosen kushtet per ndertimin; dhe
- te ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a) procesin paraprak te VNM-se;
- b) procesin e thelluar te VNM-se.

Ajencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se, merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar perqatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe ia degon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se
- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures se thelluar te VNM-se

Referuar ligjit nr. 10440/2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis", te ndryshuar projekti i propozuar per hidrocentralin "Cerenec" listohet ne Shtojcen II te ketij ligji ne piken 3 (e) "Instalime per prodhimin e energjisë hidroelektrike" dhe si rrjedhoje i nenshtrohet procedures paraprake te VNM-se.

Theksojme se gjate procedures paraprake te VNM-se, referuar VKM nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarjen mjedisore", **Kreu I nuk eshte e detyrim ligjor te behet Konsultim Paraprak me banoret e zones.** Perpara marrjes se Vendimit (sic detajohet me poshte) AKM-ja publikon aplikimin per VNM paraprake ne web te saj, ku komuniteti i interesuar mund te shpreh mendimin e tij.

Vendimi

Vendimi i AKM-se ne fund te procedures Paraprake te VNM-se percakton nese nje projekt i listuar ne Shtojcen II te Ligjt per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi, duhet apo jo t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se. Nese AKM-ja vendos se projekt i nuk duhet t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, ne vendimin e saj percakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi, mendimin e institucioneve te konsultuara, pershkrimin sipas rastit, te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur, reduktuar dhe nese eshte e mundur per te korriguar ndikimet negative te mundshme ne mjedis.



Deklarata Mjedisore

Rezultati perfundimtar i procedures se thelluar te VNM-se, eshte Deklarata Mjedisore, e cila mund te permbaje refuzimin ose miratimin me rekomandime per Autoritetin e Planifikimit per te vazhduar procesin ne baze te kushteve te specifikuara mjedisore.

Deklarata mjedisore sherben si dokument orientues per Autoritetin e Planifikimit dhe/ose çdo autoritet per gjegjes ne procesin e vendim marrjes, per nje leje zhvillimi apo per nje leje te caktuar per miratimin e nje projekti te listuar ne Shtojcat 1 dhe 2 te ligjit per Vleresimin e Ndkikimit ne Mjedis, ne fuqi.

Dokument i baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit mund te jete:

- a) raport paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar;
- b) raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar.

Baza ligjore

- Ligji Nr.8375 date 15.7.1998 per nje ndryshim ne ligjin 8093 date 21.03.1996 " Per rezervat ujore "
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar;
- Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar;
- Ligji nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" i ndryshuar
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, datë 4.2.2008 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906 datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji nr.10 253, datë 11.3.2010 "Për gjetuinë"
- Ligji Nr. 9533, datë 15.5.2006 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji Nr. 9791, datë 23.7.2007 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji Nr. 15/2012, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji Nr. 36/2013, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji Nr.9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor"
- Ligji Nr. 38/2013 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor të ndryshuar"
- Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
- Ligji Nr.9587, date 20.7.2006 "Per mbrojtjen e biodiversitetit"



- Ligji nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
- Ligji Nr.111/2012 ,date 15.12.2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore "
- Ligji Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Per lejet e Mjedisit", i ndryshuar
- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011"Per menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- Ligji Nr.9048, date 7.4.2003 " Per trashegimine Kulturore "
- Ligji Nr.9882, date 28.02.2008 per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr.9048, date 7.4.2003 " Per trashegimine Kulturore "
- Ligji Nr.8897, date 16.05.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar.
- Ligji Nr.43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike"
- Ligji Nr.138/2013, date 02.05.2013 "Per eficsenzen e energjise"
- Ligji Nr.138/2013 , date 02.05.2013 "Per burimet e energjise se rinnovushme"
- Ligji Nr.10119, date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit ", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9693, date 19.03.2007 "Per fondin kulloso"
- VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve përvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore"; dhe Vendimi nr. 95, datë 14.02.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime tek VKM nr. 686, datë 29.07.2015"
- VKM Nr.912 date 11.11.2015 "Per miratimin e metodologjise kombetare te procesit te VNM-se "
- VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarjen mjedisore"
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkeseve per menaxhimin e mbetjeve inerte"
- VKM nr.175, datë 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
- VKM nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme"
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
- VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"
- VKM nr.519, datë 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"



- Vendim Nr. 22, datë 9.1.2008 "Për caktimin e procedurave dhe të kritereve të administritimit të pyllit komunal"
- Vendim Nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kulloso"
- Vendim Nr. 396, datë 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore"
- VKM nr.897, datë 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes"
- VKM nr. 532, datë 05.10.2000 Për miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin"
- VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare"
- VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
- VKM Nr.822 date 07.10.2015 "Per miratimin e rregullave dhe procedurave te ndertimit te kapaciteve te reja prodhuese te energjise elektrike, qe jane objekt koncesioni " i ndryshuar.
- Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- VKM nr 352, datë 29.04.2015. "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".
- VKM nr.676 datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare" i cili përcakon monumentet natyrore në nivel qarku dhe rrjeti që duhet të mbrohen nga veprimtaritë e ndryshme (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë).
- VKM nr.27 datë 20.01.2016 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Energjitet e Rinovueshme".
- Vendim nr.99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre.
- VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", i cili synon tëdisiplinojë procesin e grumbullimit, transportit, dorëzimit dhe trajtimit të mbetjeve inerte në fushën e ndërtimit, duke përcaktuar rregullat dhe kërkesat konkrete për subjektet që operojnë në këtë fushë.
- VKM Nr. 342, datë 4.5.2016 "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në republikën e shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre"

Objekt i ligjit per Vleresimin e Ndkimit ne Mjedis, eshte percaktimi i kerkesave, pergjegjesive, rregullave dhe procedurave per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative mjedisore te projekteve te propozuara, private ose publike.



Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjella.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e perqatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ligji per Vleresimin e Ndiqimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te perafruara plotesisht me Direktiven e bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndiqimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimit dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Kerkesa te pergjithshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis te nje projekti:

- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin percaktimin, pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejta mjedisore te zbatimit apo moszbatimit te projektit.
- Ndiqimet mjedisore te projektit vleresohej ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e prekur ne kohen e paraqitjes se raportit perkates per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit.
- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin perqatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes se veprimtarise, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme, nese nje detyrim i tille parashikohet me ligj. Vleresimi perfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundesine per aksidente.
- Vleresimi i projektit perfshin, gjithashtu, propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve te tillë ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjate zbatimit te projektit, perfshire edhe vleresimin e efekteve te pritshme te masave te propozuara.

Aspektet me te rendesishme te procesit paraprak te VNM-se, jane konsultimet me palet e tjera dhe vendimi nese kerkohet nje VNM e thelluar.



VNM paraprak eshte faza e pare e procesit te VNM. Sipas Nenit 8 te ligjit te VNM qellimi i VNM Paraprak eshte te identifikoje propozimet qe kerkojne VNM te thelluar. VNM Paraprak perjashton nga procesi ato propozime (shumicen) qe nuk kane ndikime te rendesishme, ose pak, ndikime lehtesish te kontrollueshme, dhe per te cilat VNM eshte e panevojshme.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak jane:

- Paraqitja e kerkeses dhe dokumentacionit shoquerues nga zhvilluesi ne Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe percjellja e tyre nga Ministria ne Agjencine Kombetare te Mjedisit (AKM);
- Kontrolli teknik paraprak i bere nga AKM dhe konsultimi i AKM me insolucionet e tjera dhe publikimi i aplikimit;
- AKM njofton per vendimin e marre, nese projekt i eshte apo jo e nevojshme ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM, Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit dhe palet e perfshira ne proces, dhe publikon vendimin ne faqen e internetit te AKM.

Konventat dhe marreveleshjet nderkombetare ne lidhje me procesin e VNM-se

Direktiva e Këshillit të BE-së 97/11/EC e cila modifikoi Direktivën 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon qe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të kërkojnë kryerjen e një vlerësimi të ndikimit mjedisor (VNM) për projektet që mund te rezultojne me ndikim te rendesishem në mjedis. VNM duhet të pergatitet para miratimit të projektit, në mënyrë që vendimi për miratim të marre paraysh ndikimet e mundshme të projektit në mjedis. Direktiva paraqet një listë të projekteve që kërkojnë studimin e VNM në të tëra rastet (Shtojca 1) dhe një listë të projekteve që mund të kërkojnë një studim të permblehdhur VNM (Shtojca 2), në varësi të një vlerësimi per ndikimet e mundshme qe mund te rezultojne nga projekti i propozuar apo te kritereve kufizuese, të vendosura nga secili shtet anëtar. Propozimi aktual konsiderohet si një projekt i Shtojcës 2.

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti per:

- Qëniot njerëzore, floren dhe faunen;
- Token, ujin, klimen dhe peizazhin;
- Asetet materiale te trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimi midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër qe percaktohet ne direktive qe duhet te përfshihen në studimin e VNM-se jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;
- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe te teknologjise te marra ne shqyrtim per projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shume nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, tokën, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;



- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, clirimi/shkarkimi i lëndëve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në cështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqiperia eshte anetare dhe ndjek detyrimet e konventave te me poshtme nderkombetare:

- Konventa e Bernit (CH) "Per mbrojtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisin e saj natyror ne Evropë.", miratuar me ane te ligjit nr 8690, me 2 Mars 1998;
- Konventa e Barcelones "Per mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujor te Mesdheut" dhe protokollet e saj;
- Konventa e Bonit "Mbi mbrojtjen e faunes se eger shtegtare";
- Konventa e Vienes "Mbi kontrollin e kalimit kufitar te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre", miratuar me ane te ligjit nr. 8216, me 13 Prill 1997;
- Konventa e Vienes "Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit" dhe protokolli i Montrealit "Mbi substancat qe demtojne shtresen e Ozonit";
- Konventa e Aarhusit "Mbi te drejten e publikut per t'u informuar, per pjesemarrje ne vendim-marrje dhe e drejta per t'iu drejtuar organeve te drejtësise per cështjet mjedisore", miratuar me ligjin nr. 8672, me 26 Tetor 2000;
- Konventa "Vleresimi i Ndkimit ne Mjedis ne kuadrin Nderkombetar". Hyr ne fuqi ne 4 Tetor 1991;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Tetor 1994;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Biodiversitetin, Janar 1994;
- Kombet e Bashkuara "Konventa kunder zgjerimit te shkretetirave ne vendet e thata, veçanerisht ne Afrike". Hyrja ne fuqi me 27 Prill 2000.

Në zbatim të kërkesave të legjislacionit mjedisor shqiptar, çdo projekt i cili synon të zhvillohet në mjedis, që në fazat e para të tij duhet t'i nënshistrohet Vlerësimi të Ndkimit në Mjedis të aktivitetit që propozon, në mënyrë që të garantohet një proces i drejtë të vendimmarrje në lidhje me të.

Kryerja e Vlerësimit të Ndkimit në Mjedis të një aktiviteti të propozuar, proces i cili finalizohet me hartimin e Raportit përkatës, synon konsiderimin e cështjeve që lidhen me mjedisin pritës, fizik e social, që në fazat fillosefare të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të



zbatimit të tij. Nëpërmjet identifikimit të ndikimeve të mundshme negative të zbatimit të projektit në vlerat natyrore të zonës pritëse, që në fazën e projektimit mund të merren masat e nevojshme për përmirësimet e duhura teknologjike, me qëllim zbutjen e ndikimeve dhe përshtatjen me kapacitetin bartës të mjedisit.

Qëllimi i kryerjes së Vleresimit të Ndkimit në Mjedis të projektit të propozuar është:

- Të japë informacion për vendimmarrësit për pasojat mjedisore të tij.
- Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm me mjedisin duke propozuar masat e nevojshme për shmangien dhe minimizimin e ndikimeve të mundshme negative të identikuara gjatë këtij procesi.
- Kryerja e Vleresimit të Ndkimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar do të realizohet nëpërmjet përbushjes së objektivave specifike si:
- Evidentimit të pikëprerjeve dhe bashkërendimit të projektit me kuadrin rregulator legjislativ kombëtar dhe ndërkontrollor në fushën e mjedisit.
- Identifikimit të statusit të zonave ku do të zhvillohet projekt.
- Përshkrimit të vlerave natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit.
- Identifikimit të ndikimeve të mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i VNM përbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative (PMM) dhe programin e monitorimit mjedisor.

➤ **PERSHKRIMI I PERMBLEDHUR I KUADRIT LIGJOR MJEDISOR EDHE INSTITUCIONAL QE LIDHET ME PROJEKTIN**

Hartimi i raportit të Vleresimit te Ndkimit ne Mjedis (VNM) per aktivitete te ndryshme kerkohet mbështetur ne nje kuader ligjor tashme pothuajse të plotesuar.

Raporti i Vleresimit te Ndkimit ne Mjedis per ndertimin e hidrocentralit "Cerenec" eshte hartuar duke u mbeshtetur ne legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Ne kete raport gjithnjë duke pasqyruar kërkesat e kuadrit ligjor, do të pasqyrohen ndikimet negative e pozitive të këtij aktiviteti, masat mbrojtese e zbutese ne rastet kur demtohet mjedisi ose elementët përbëres të tij.

Reabilitimi i mjedisit është nje pike kryesore e cila rrjedh nga kuadri ligjor por qe tashme është bere i domosdoshem, jo vetem ne projektim por edhe ne zbatim.

Përgatitja e Raportit të Vleresimit të Ndkimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", nen 25, i cili përcakton kërkesën për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.
- Ligj nr.10440 datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtron, përgjegjësitet e palëve në proces.



- Ligj nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i cili ndër të tjera synon sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit.
- Ligj nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i cili kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e specieve biologjike dhe mbrojtjen e vlerave biologjike ku përfshihen edhe ekosistemet dhe habitatet. Ligji kërkon që veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura ose jo të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t'u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore.
- Ligj nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, qëllimi i të cilit është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to. Ligji sanksionon që, në zonat e mbrojtura mjedisore, veprimtaritë mund të ushtrohen vetëm pasi të jetë marrë më parë leja e mjedisit ose pasi të jetë marrë miratimi me shkrim i organit të mbrojtjes së zonës, në rastet kur kjo kërcohët shprehimisht nga ky ligj.
- Ligj nr.138/2013 “Për burimet e energjisë së rinnovueshme” i cili, ndër të tjera synon të nxitë përdorimin e teknologjive dhe novacioneve për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehësisë nga burime të rinnovueshme energjie, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.
- Ligj nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili ka për qëllim të mbrojtjeve mjedisore dhe shëndetin e njeriut si dhe të sigurojë administrimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre.
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangjes dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma.
- Ligji nr.9672 datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimarrje, si dhe për t'i u drejtar gjuhatës për çështjet e mjedisit”.
- Ligji nr.9334 datë 16.12.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos” në konventën për ndryshimet klimatike (UNFCCC).

Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te VNM –se

Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua :

- nga rendesia e ndertimit dhe shfrytezimit te Hec-it “CERENEC” me standartet bashkekohore.
- nga permbushja e kerkesave vendase dhe te huaja.
- nga vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore e humane te zones si dhe vlerave te vecanta te tyre.
- ne idenitifikimin e ndikimeve negative dhe lokale.



- ne marrjen e masave zbutese , duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike te investimit.
- ne masat orientuese per nje zhvillim te qendrueshem etj.

Ne kete raport identifikohen ndikimet lokale e negative ne mjediset humane, si dhe eshte mare parasysh vleresimi i rrezikut.

Reduktimi i ndikimeve negative, eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme lokale dhe strukturore ne keto faza kyesore:

- Hartimi i objektivave orientuese te Raportit te VNM-se.
- Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe plotesimi i formularit perkates per kete raport (relacioni teknik, studimi gjeologo-inxhinierik, hidrologjik, etj), si dhe seleksionimit te tyre per perdorim.
- Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundshme biofizike dhe humane.
- Hartimi i VNM-se dhe dorezimi tek porositesi, si dhe ne subjektet vendimarese dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal dhe qendror.

Ndërsa korniza rregullatore shqiptare i referohet vetëm Vleresimit të Ndkimit në Mjedis (VNM), sheh edhe ndikimet sociale të Projektit sipas praktikave ndërkontëtare më të mira.

Përmes procesit të Vleresimit të Ndkimit Mjedisor dhe Social (VNMS), identifikon, adreson dhe menaxhon të gjitha ndikimet, rreziqet dhe mundësítë sociale, mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

Është e rëndësishme të nënvojimë se jane marre në konsideratë alternativat gjatë fazës së hartimit të projektit.

Kjo kërkesë, lidhur me diskutimin e alternativave është e rëndësishme për një sërë arsyesh:

- Na ka nxitur që të mendojmë me kujdes rrëth çështjes së objektivave që shtyjnë përpala propozimit te projektit për miratim dhe nëse ekzistonjë mundësítë e arritjes së objektivave me sa më pak ndikim në mjedis;
- Diskutimi mbi alternativat krijon një sfond të dobishëm mbi historikun e projektit si dhe si kanë evoluar propozimet gjatë zhvillimit të tyre;
- Gjatë argumentimit të tyre për përgjedhjen e projektit të tyre, ne jemi inkuruar për dhënien e shpjegimeve të nevojës për vënien në jetë të tij dhe se si përkon me objektivat politike, rregullatore dhe ekonomike;
- Kjo i bën me dije autoritetet kompetente për sasinë e opsiioneve në dispozicion që ,mund të merren parasysh për shbangjen ose reduktimin e ndikimeve negative;
- Lejon palët e interesuara të kuptojnë arsyet e zhvilluesit për propozimin e projektit në fjalë;

Marrja në konsideratë e alternativave:

- Shpjegon arsyen pse zhvilluesi ka hartuar projektin në fjalë;



- Përshkruan procesin përmes të cilit zhvilluesi ka arritur në projektin në fjalë;
- Përshkruan alternativat që janë marrë parasysh gjatë procesit;
- Përgjithëson avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej alternativave, përfshi dhe çështjet mjedisore;
- Shpjegon si u morën parasysh në marrjen e vendimit rreth propozimit;
- Nëse alternativat më të mira janë hedhur poshtë, shpjegon arsyet pse faktorët e tjerë u konsideruan si më të rëndësishëm në avantazhet mjedisore.

Alternativat, që janë të përshtatshme ne projektin konkret, Jane marrë në konsideratë gjatë hartimit të tij, me qëllim që të programohen veprimtaritë e duhura gjatë studimeve mjedisore.

Marrja në konsideratë e alternativave të ndryshme është një nga kërkesat bazë për procedurat e VNM. Analiza dhe krahasimi i alternativave të ndryshme (si në nivel strategjik dhe të një projekti) nënkupton balancimin e tipeve të ndryshme të ndikimit, duke njojur të mirat e çdo opzioni dhe eventualisht arritjen e një renditjeje të preferencave ndaj tyre. Kjo kërkon një kuadër që integron informacionin faktik mbi efektet dhe ndikimet, me vlerat dhe preferencat e vendimmarrësve dhe palëve të interesuara.

Lista e plotë e llojeve të alternativave të paraqitura më poshtë ka konsideruar opzionet specifike që mund të jenë të përshtatshme per projektin e propozuar, duke marrë parasysh objektivat e zhvilluesit në promovimin e zhvillimit.

Llojet e alternativave:

- Masa për të menaxhuar kërkesën për mallra apo shërbime (p.sh. veprimet e efikasitetit të energjisë)
- Masa për të ruajtur ose zvogëluar konsumin e burimeve (p.sh. kontrollimi rrjedhjes)
- Qasjet e ndryshme për të përbushur kërkesën
- Vendndodhjet ose rrugët
- Proseset ose teknologjite
- Metodat e punës (p.sh. trajtimin e materialeve manualisht apo automatizim)
- Planet e vendodhjes dhe pamja që do të kenë
- Projekti i strukturave (p.sh. madhësia e ndërtimit, forma apo paraqitja)
- Llojet dhe burimet e materialeve (p.sh. burimet të aggregateve vendore apo të importuara)
- Kohëzgjatja e ndërtimit, operimit dhe mbylljes në çdo fazë
- Datat e fillimit dhe përfundimit (p.sh. fillimi i ndërtimit në verë apo dimër)
- Madhësia e vëndit ose objektit (p.sh. zona e hapësirës së hapur)
- Numri i njësive operuese (p.sh. stacionet/terminalet , vënd-parkimet)
- Kontrolli i hyrjeve dhe rrugët për trafikun nga dhe në objekt/strukturë



- Sigurimi dhe vendndodhja e objekteve ndihmëse (p.sh. hedhja e mbeturinave, furnizimi me energji elektrike, strehimi)
- Sistemimi i prishjeve, rehabilitimi i sipërfaqes/territorit dhe kthim në gjendjen e mëparshme
- Të Mos Bësh Asgje (skenari pasiv) ose zhvillime minimale

Qasje e perdoruara per të filtruar informacionin në lidhje me mënyrën se si alternativat performojnë kundrejt kriterit të vlerësimit me qëllim që të zgjidhen opzioni ose opzionet e preferuara. Këto janë paraqitur më poshtë:

1. renditja
2. klasifikimi
3. vlerësim me pikë dhe ponderimi
4. vlerësimi monetar
5. krahasimi çifteve

➤ **PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

Hidrocentrali “Cerenec” shfrytezon ujrat e lumit te Zallit te Bulqizes dege e lumit Drin i Zi , rrjeti Bulqizes, qarku Diber dhe komuna e Cerenece. Ky hidrocentral do te kete fuqi te instaluar $N=1960$ kW dhe prodhim mesatar vjetor $E = 9.751.663$ kWh/vit.

Pellgu ujembledhes i HEC “Cerenec” brenda perbrenda perfaqeson një terren para malor dhe malor dhe nis nga lartesite 1701.7 m (mali Temlit), ku nisin buret e para te rrjedhjes se ujit ne studim. Ky hidrocentral fillon direkt pas Hec-Peladhi ne kuote $\nabla 481.00$ m (Kuota e frontit kaperderdhes) qe eshte dhe niveli normal ne basen te presionit deri ne kuoten ne kuoten $\nabla 465.00$ m m.n.d ne godine centrali.

Per perroin e mesiperm kompania “RAJFI” shpk kerkon shfrytezimin nga kuota 481.00m ($X=4451764; Y =4598710$) deri ne kuoten 465.00 m ($X=4452760; Y=4600273$).

Parametrat konstruktiv dhe energjitet.

Tipi i turbinës:	3 Francis
Fuqia e instalua:	$N = 1960$ kW
Energjia e prodhuar:	$E = 9.751,663$ kWh
Sipërfaqa e pellgut:	$A = 440$ km ²
Prurje llogaritese:	$Q_{llog} = 20$ m ³ /sek
Rënia bruto:	$H_b = 15.0$ m
Rënia neto:	$H_n = 11.6$ m



1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI

Flora

Veshja bimore është e përqendruar ne pjesën e sipërme te pellgut ujëmbledhës ku përhapje me te gjere kane kullotat alpine (1800m) dhe ne lartësi mbi 1200m gjendet ahu. Ne pjesën e mesit dhe te poshtme te pellgut mbizotërojnë dushqet dhe shkurret.

Bimësia ahut, gjithmonë, gjendet e përzier, por, sipas ndikimi të njërit apo tjetrit faktor ekologjik, ndodh mbizotërimi i njërit apo tjetrit lloj. Kështu, pisha e zeze dhe e bardhe mbisundon ne Bajgjaj, malin e Bardhe etj. Sipërfaqe të mëdha, të zëna më parë nga bimësia e dushkut e lisit dhe qarrit në terrenet fushore dhe në disa zona të atyre kodrinore, janë shpyllëzuar dhe janë mbjellë me bimë bujqësore. Kjo ka sjellë ndikimet e veta në regjimet ujore të përrrenjve që i përshkojnë këto zona.

Në zonën fushore e kodrinore, faktori antropogjen ka ndikuar në tjetësimin e vlerave natyrore të bimësisë duke i kthyer në terrene me bimësi bujqësore. Bimësia në buzë të lumit, në zonën fushore, është, përgjithësisht, e uniformizuar, e izoluar dhe e dëmtuar. Brezi mbrojtës natyror është zvogëluar nga ndërhyrjet e ndryshme. Areali i bimësisë buzë Drinit është limitizuar shumë, meqënëse lumi ka një shtrat më të fiksuar, si dhe një debit prurjesh mesatare më të pakët.

Fondi pyjor ku përfshihen zonat me bimësi pyjore, kullotat, sipërfaqet djerrë dhe inproduktive zë rrëth 80% të sipërfaqes në Bashkinë Bulqize. Këto pasuri ofrojnë prodhime, shërbime dhe funksione mjedisore të pazëvendësueshme dhe banorët e zonave rurale e kanë të lidhur ngushtë jetesën e tyre me këto pasuri natyrore. Bimët mjekësore, dellina sherbela, shtara, caji i malit, molla e eger janë një burim i madh të ardhurash për popullsinë e Rrethit të Dibres.

Flora është shumë e pasur dhe përbëhet nga 3200 lloje, prej të cilave mbi 300 lloje trajtohen si bimë mjeksore, etero-vajore e tanifere. E rëndësishme është se pjesa më e madhe e këtyre bimëve i janë përshtatur rritjes dhe zhvillimit në terrene të thyera, në toka të varfëra e të thata ku bimët e tjera bujqësore nuk mund të rriten qoftë edhe me anën e kultivimit.

Fauna

Shpendët e gjitarët janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit të lumit te Zallit te Bulqizes e të përrrenjve që e ushqejnë. Ujërat e këtij rrjeti, veçanërisht për gjitarët, janë element mjaft jetik. Gjitarë të mëdhenj si ujku (*Canis lupus*), çakalli (*Canis aureus L.*), derri i egër (*Sus crifa L.*) janë vizitorët më të shpeshtë të lumit e përrrenjve, në varësi të aktivitetit të tyre jetësor. Gjitarë të tjerë si lundërza (*Lutra lutra L.*) e kanë lidhur jetën e tyre me mjedisin ujor lumor të cilit i përkasin.

Në një farë kuptimi, faktori antropogjen nuk ka ndikuar aq shumë në luginat e thella të përrrenjve malorë, të cilat kanë mbetur kështu njedise të favorshme dhe me potenciale për riprodhimin e shpendëve dhe gjitarëve. Në zonën në shqyrtim dallohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë si derri i egër (*Sus crifa L.*), thëllëza e fushës (*Perdix perdix L.*), kumuria (*Steptopelia decaocto Friv*) etj. Veç tyre, në këtë zonë, janë të përhapur dhe mjaft gjitarë me rëndësi ekonomike si dhelpra (*Vulpes vulpes L.*), kunadhja (*Martes faina Elx L.*), zardafë (*Martes martes L.*), baldosa (*Meles meles L.*) qelbësi (*Mustela putorius L.*), ketri (*Sciurus vulgaris L.*), lundërza (*Lutra*



lutra L.) dhe shpendë si thëllëza e malit (Alectoris graeca Meisner), pëllumbi i egër (Columba L.), turtulli (Streptopelia turtur L.) Në avifaunën e rajonit në shqyrtim bëjnë pjesë shpendë karakteristikë të shkurretave e të pyjeve, por dhe të mjesdit urban (Athene noctua, Falco tinnunculus, Anthus campestris, Corone cornix, Corvus corax, Pica pica, Passer domesticus, Carduelis carduelis, etj). Veçanërsisht më të njojur janë mëllenja (Turdus merula), gargulli i zi (Sturnix vulgaris), lauresha (Aleuda arvensis), turtulli (Streptopelia turtur), qukapiket, trishtilat, harabelat, gushëkuqët etj. Nga reptilët gjenden më shumë Lacerta viridis, Podarcis muralis, Anguis fragilis, Vipera amodytes, Natrix sp., Coluber sp., e breshka e zakonshme (Testudo hermanni, Gmel).

Habitatet me lagështirë kanë favorizuar instalimin e mjaft amfibëve, ku më të njojur janë bretkosat, si ajo e zakonshme (Rana ridibundo Pall), bretkosa e pyllit (Rana dalmatika Boul, Rana graeca), thithlopa e zakonshme (Bufo bufo), thithlopa e gjelbër (Bufo viridis Laur), verorja (Hyla arborea), (Bombina variegata) etj.

- **Pershkrimi i zones se mbrojtur prane vendit ku propozohet projektit.**

Zonat e mbrojtura me prane zones se projektit jane pershkruar me poshte , por projekti i propozuar **nuk i prek ato**.

1. ZONA E MBROJTUR: "KORAB-KORITNIK"

Kategoria: Rezervat Natyror i Menaxhuar / Park Natyror (IV)

Vendimi me të cilin është shpallur:

V.K.M nr.898 date,21.12.2011

Sipërfaqja, vendodhja, kordinatat:

Ka një sipërfaqe prej 55.550.2 ha . Nga kjo sipërfaqe 34,886.8 ndodhen në territorin e qarkut Kukës dhe 20,663.4, në territorin e qarkut Dibër. Parku është pjesë edhe e zonës ndërkuqitare me Parkun Kombëtar të Mavrovës (Maqedoni) dhe nëpërmjet një bio-korridori lidhet me Parkun Kombëtar të Sharrit (Kosovë).

V 445578.15l 4659256.82v

L 4463004.61l 4668805.51v

J 4463238.36l 4605429.25v

P 4459468.97l 46033467.39v

Rrugët me anë të të cilave shkohet në destinacion: Rruja nacionale.

Nga Kukësi në drejtim ZM Korab-Kortinik mund të shkohet në disa drejtime, me rrugë auto, Kukës-Shishtavec 32 km, Kukës-Grykë-Çajë 37km, Kukës-Kolesjan-Kroi i bardhë 35km, Kukës- Zapod 17km. Nga Dibra; Peshkopi -Kala e Dodës –Radomirë , Kala e Dodës- Sorokol.

Përfaqësuesit specifik të Florës dhe Faunës:

Rriten rrëth 46 specie të rëndësishme bimore të futura në listën e Specieve të Rrezikuara të Vendeve të Rëndësishme Bimore të Shqipërisë si Asyneuma comosiforme, Cirsium boujartii, Melampyrum heracleoticum, Moltzia doerfleri, Oxytropis corabensis, Oxytropis prenja., Phyteuma pseudorbicularis, Fritillaria macedonica, Crocus scardicus, Asperulla scutellaris, Pinus heldreichi var. leucodermis, Ramonda serbica, Ranunculus degenii, Ranunculus wettsteinii,



Scrophularia bosniaca, Silene macrantha, Valeriana berliscea, Viola elegantula, Viola kosaninii, janë në listën e kuqe të specieve të rrezikuara me rëndësi globale

Grupi i vertebrorëve në zonën e Korabit përfaqesohet në tërësi nga 205 lloje. Grupi më frekuent është ai i shpendëve me 135 lloje, i ndjekur nga grupi i gjitarëve me 30 lloje. Më pas vijojnë peshqit me 15 lloje, reptilët me 14 lloje dhe së fundi amfibët me 11 lloje. Ndër këta vertebrorë të paktën 74 lloje hyjnë në kategorinë e specieve të kërcënuara në shkallë kombëtare. Këtu bëjnë pjese 14 lloje reptilësh, 11 amfibë, 39 shpendë dhe 10 gjitarë.

Përveç tyre zona e Korabit strehon dhe 11 lloje të cilat janë globalisht të kërcënuara përfshirë 1 lloj peshku, 2 amfibë, 3 reptilë dhe 6 gjitarë.

2. ZONA E MBROJTUR: ZONË E MBROJTUR E BURIMEVE TË MENAXHUARA
LUZNI-BULAÇ

Kategoria: VI Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara

Vendimi me të cilin është shpallur: VKM 102 date 15.01.1996

Sipërfaqja, vendndodhja-kordinatat: 5900 ha, Bulqizë

Kordinatat:

V 44400834.081 4609120.46v

L 4444867.801 4615430.57v

J 4450859.04L 4607097.40V

P 4443632.811 4604901.96v

Rrugët me anë të të cilave shkohet në destinacion

1. Rruga nacionale

Përfaqësuesit specifik të Florës dhe Faunës

Pyje ahu të përzier me dushk, shkurre

Ujku, ariu, dhelpra, deri egër






Figura 1: Largesia e zones se projektit nga Zonat e mbrojtura me te afera.

Sic shihet nga harta e mesiperme zona ku do te shtrihet Hec Cerenec nuk prek zona te mbrojtura apo monumente natyre



➤ *Foto nga mbulesa bimore e siperfaqes ku do te zbatohet projekti:*



Figura 2: Foto nga mbulesa bimore e siperfaqes ku do te zbatohet projekti

2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKAUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI.

Pellgu i Zallit te Bulqizes paraqitet me një rrjet hidrografik mjaft te pasur. Lumi kryesor qe rrjedh ne territorin qe perfshin bashkine Bulqize eshte Zerqani dhe Okshtuni. Lumi Drin përshtkon 6.85 km ne territorin e bashkise se Bulqizes, ky lum buron nga lijeni i Ohrit, pas daljes nga ky lijen ne qytetitn e Struqes vazhdon rruqen neper një sere grykash te ngushta te cilat rrebarojne ne Uren e Spilese.

Arteri kryesor i Drinit, pasi kalon ne kufijt shteteror te vendit eshte Zalli i Bulqizes. Zalli i Bulqizes, i cili buron ne liqenet e Balgajt, merr me vete shume perrenj te vegjel e perroska, formohet nga bashkimi i ujerave te lumbit te Okshtunit dhe te lumbit te Zerqanit.

Ne per gjithesi pellgu ushqehet nga rreshjet e shiut e te debores. Ne kete kompleks futen depozitimet aluviale, deluviale, proluviale e koluviale te cilat ne pikepamjen hidrogeologjike nuk perbejne rendesi per rezervat ujore te pellgut ne fjale ne lidhje me interesat e vepres qe do ndertohej, duke qene se keto depozitime jane kryesisht depozitime te shkrifeta dhe gjenden te depozituara ne segmentet me pjerresi me te bute te lugines, kryesisht ne shtratin e perroit dhe rralle ne diferenca kuote me shtratin e tij. Keto depozitime kane rezerva ujerashe nentokesore por duke qene se vendosen kryesisht ne kuotat e uleta nuk jepin burime ose jepin burime te perkoheshme me debit te vogel.

Burimet gjinden te gjitha ne lartesi te ndryshme.



➤ Prurja llogaritese dhe prurja ekologjike

Prurje ekologjike konsiderohet prurja me qëndrueshmëri 355 ditë (Q355), prurja bazuar në prurjen e mesatareve ditore të studimit hidrologjik e cila nuk tejkalohet më shumë se 355 ditë në një vit.(ReferuarLIGJIT Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE).




Figura 3: Kurba e qendrueshmerise se prurjeve ditore per vitin mesatar me siguri 75% , 50% dhe 25 % ne aksin e veprave te marjes Hec “Cerenec”

Pra ne rastin tone bazuar ne kurben e qendrueshmerise te paraqitur me siper ajo ka vleren Q355= Qamb = $1.0 \text{ m}^3/\text{sek}$

Prurja llogaritese rezulton $Q_{\text{llog}}=20 \text{ m}^3/\text{s}$. Me kete prurje do te dimensionohen te gjitha veprat perberese te HEC- it, si dhe do te nxirren parametrat hidroenergjite te tij. Prurja llogaritese ka dal duke zbritur prurjen ambientale.


Persa i perket prurjes per ujitje , per te siguruar nevojat e komunitetit ne afersi te zones ne studim per ujitje, do te meren masa per lenien e prurjes se nevojshme gjate muajve te veres.

LIGJI Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE

Neni 39

Përdorimi i burimeve ujore

1. Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administritimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e mjedisit.



2. Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë.
3. Sasia e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup ujor natyror përcaktohet sipas planeve të menaxhimit të baseneve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke u bazuar në karakteristikat specifike dhe vlerat natyrore e ekologjike që ka baseni ujor.
4. **Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355).**

3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR

Procesi i parashikimit përbëhet nga një numër fazash, përfshirë vendimin se si të pëershkuash ndikimet, mbledhjen e të dhënavë lidhur me projektin dhe mjedisin dhe selektimin dhe aplikimin e metodës së parashikimit. Pasiguria mund të shfaqet te secila nga këto faza:

Përshkrimi i ndikimit

Ka një sërë kriteresh për marrjen e vendimit se si të përshkruhet një ndikim. Këto përfshijnë:

- natyrën e ndikimit në vetvete, psh. vendndodhjen dhe shtrirjen, kohën dhe karakteristika të tjera të lidhura me të;
- llojin e standardeve ose kritere të tjera kundrejt të cilëve do të vlerësohen parashikimet;
- aftësia dhe mundësia e metodave për të bërë lloje të ndryshme parashikimesh (mesatare/amplituda maksimale, afat shkurtra/gjata, afér/larg, etj.).


Vendimi për përshkrin e ndikimit duke përdorur një masë se sa atë që mund të çojë në një përfundim të ndryshëm rreth ndikimit. Për shembull, përqëndrimi ndotës vjetor mesatar i parashikuar mund të jetë brenda limitit ligjor, por përqendrimi maksimal mund të jetë i mjaftueshëm per te shkaktuar një dëm të rëndësishem. Falë kësaj, do të ketë gjithmonë një shkallë pasigurie nese mënyra se si është përshkruar një ndikim, ka ndikuar ne vendimin rreth rëndësisë së tij.

Mbledhja e të dhënavë

Do të ketë gjithmonë pasiguri në të dhënat që duhen për të bërë parashikimet. Këto mund të jenë të dhëna rreth vetë aktivitetit; për shëmbull, sa mbetje do të depozitoohen në një vendndodhje të propozuar? Cila është përbërja e tyre kimike? Mund të lidhet edhe me mjedisin bazë që ndikohet: sa është popullata lokale e specieve të ndikuara. Cilin proporcion të popullatës kombëtare rajonale përfshin? Çfarë kanalesh bëjnë të mundur shpërhapjen e ndotesve? Cilat janë kushtet lokale të shpërhapjes në ajër, tokë dhe ujë? Sa njerëz jetojnë në vendndodhjen e projektit?

Të dhënat janë subjekt i dy lloj pasigurish:

- Pasaktësia në matje dhe zgjedhjen e mostrave – saktësia e instrumenteve, teknika dhe përdoruesi si dhe frekuanca e matjeve shkalla e modelit të zgjedhur;



- Ndryshueshmëria natyrale dhe e pashmangshme në mjedis – p.sh, kushtet mesatare te motit do të ndryshojnë gjatë një viti dhe ndër vite; nivelet e prurjes së lumit lagështia e tokës ndryshojnë në kohë, po ashtu popullimet dhe riprodhimi i specieve; përbërja e ndryshme gjenetike e individëve në një popullim mikroorganizmash do te rezultoje ne një ndryshuesheri te reagimit te tyre ndaj ndotjes së tokës.

Selektimi dhe aplikimi i metodës së parashikimit

Të gjitha metodat parashikuese, kur përdorin modele shkencore ose gjykime ekspertësh, përfshijnë disa modele të mjedisit: matematike, fizike, eksperimentale ose konceptuale (verbale/mendore). Pasiguritë ndodhin sepse asnjë nga këto modele nuk mund të parashikojë se çfarë do të ndodhë ne mjedisin e vërtetë. Modeli është vetem një përafersi e botës reale dhe përfundimet nuk mund të japid një përshkrim të saktë dhe preciz të asaj që mund të ndodhë.

Punimet që do të realizohen kryesisht gjatë stadir të ndërtimit të objekteve të veprës hidroenergitike vlerësohet se do të shkaktojnë ndikime të drejtpërdrejtë të moderuar në Mjedisin e zonës (koha e kufizuar e ndikimit), të cilat janë të domosdoshme të vlerësohen në kuadrin e mbrojtjes efektive natyrore dhe të përballohen me marrjen dhe zbatimin e masave të kontrollit parandalues dhe rezultativ.

Gjatë punimeve në terren te veprave te marrjes, baseneve te presionit, ndërtesave te centraleve, kanaleve te shkarkimit dhe punimeve për hapjen e rrugëkalimeve të makinerive, do të kemi zhvendosje të materialeve inerte sipas profilit të punës.

Nevoja për transportin e materialeve të ndryshem ndërtimore do të kërkojë hapje rrugësh të cilat pas përfundimit mund te rehabilitohen thuajse tërësisht. Por nga ky aktivitet nuk krijohen shqetësime për komunitetin sepse zona rurale është larg terrenit të punimeve. Gjatë punës, punonjësit nuk do të kenë shqetësime sepse pjesa me e madhe e punimeve janë nën regjimin e lageshtirës, gjë që eleminon pranine e pluhurave. Për sa u përket makinerive dhe paisjeve do të perdoren në kushte teknike të përshtatshme.

Punimet ndërtuese të veprës hiroenergitike do të jenë nën mbikqyrjen e specialistëve për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe minimizimin e faktoreve me impakt negativ mjedor. Nuk do të ketë ndikim të terthortë, pasi nuk ka ndikim të grumbulluara kohë më parë, apo të zhvendosur në distance.

Aspekteket më të mundshme të ndikimit ne mjedis dhe shendet të projektit gjatë ndërtimit:

Gjatë ndërtimit të veprës aspektet më të mundshme të ndikimit mjedor janë:

- a) Ndryshimi i strukturës së tokës.
- b) Krijimi i pluhurave nga gërmimi, ndërtimi, qarkullimi i mjeteve dhe transporti i materialeve.
- c) Efekti i zhurmave të makinerive.
- d) Ndryshimi i reliefit të sotëm natyrore.
- e) Ndotja e tokës dhe e ujërave nga rrjedhjet.
- f) Efekti i erozionit gjate hapjes së rrugëve dhe elementëve të veprës.
- g) Ndikim nga gazrat dhe mjetet motorike.
- h) Ndikim në infrastrukturën egzistuese.
- i) Ndikim në komunitet.
- j) Ndikim në regjimin dhe përbërjen e faunës.



- k) Ndikimi në regjimin dhe përbërjen e florës.
- l) Ndikime në nivelin e zhurmave.
- m) Ndikime në popullsi.
- n) Ndikime në transport dhe infrastrukturë.
- o) Ndikime në burimet natyrore.
- p) Ndikim në shëndetin e njerzve.
- q) Ndikim në estetikën dhe peisazhin.
- r) Ndikim në trashegimin kulturore.
- s) Ndikim në zonat e mbrojtura.
- t) Ndikim në sektorët e perbashkët të komunitetit.
- u) Ndikim në ambjentet e brendëshme.
- v) Ndikim në regjimin e mbetjeve.

Ndikimet në mjedis nga aktiviteti në veprën hidroenergitike klasifikohen:

Sipas kohezgjatjes së aktivitetit.

1. Ndikime afat shkurtër.
2. Ndikime afatgjata.

Sipas shkallës së ndikimit.

1. Ndikime shumë të vogla.
2. Ndikime të vogla.
3. Ndikime të mëdha.
4. Ndikime shumë të mëdha.

Sipas nivelit të mundshëm të kthimit fillestar të gjëndjes së krijuar.

1. Gjendje e kthyeshme pa zbatimin e masave të vecanta.
2. Gjendje e kthyeshme pas zbatimit të masave të vecanta.
3. Gjendje e kthyeshme pjeserisht.
4. Gjendje e pakthyeshme.

Sipas drejtimit të veprimit.

1. Influencë pozitive.
2. Influencë negative.



Faktoret mjedisore mbi te cilet ushtrohet ndikimi ne mjedis.

Vleresimi i Ndikimeve Mbi Karakteristikat Abiotike

➤ **Vleresimi i Ndikimeve mbi Mikroklimën**

Ndikimet nga clirimi i smogut nga makinerite dhe ndryshimi i temperaturave

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndikimet nga clirimi i smogut nga makinerite dhe ndryshimi i temperaturave	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I papërfillshëm
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat-shkurtër
	Rikthimi i gjendjes	I rikthyeshem

Gjatë fazës ndërtimore të projektit parashikikohet emetim i smogut nga punimi i makinerive ne zonen e projektit, duke shkaktuar ne kete menyre ndryshime ne temperature si rrjedhoje e levizjes se masave ajrore. Kohëzgjatja e këtij ndikimi do të zgjasë aq sa do të zgjase faza ndërtimore e projektit dhe shkaktohet për shkak të lëvizjes dhe fuksionimit të makinerive të rënda.

➤ **Vleresimi i Ndikimeve mbi Karakteristikat Tokesore**

Gjatë punimeve per zbatimin e projektit një nga ndikimet e mundshme që mund të ushtrohet në tokë është edhe fenomeni i erozionit.

Ndikimet e ushtruara ne toke nga shkarkimi i ndotesve

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndikimet e ushtruara ne toke nga shkarkimi i ndotesve ne te	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I papërfillshëm
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat-shkurter
	Rikthimi i gjendjes	I kthyeshem



Përdorimi i makinerive gjatë fazës ndërtimore mund të shkaktoj ndotjen e tokës nga mbetjet e ndryshme (vajrat e djegur, lende djegese etej) nëse ndodh te kete derdhje aksidentale.

➤ **Ndikimet e Shkaktuara nga Vellimi i Mbetjeve te Prodhua**

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndikimet e shkaktuara nga vellimi i mbetjeve te prodhua	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I vogël
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat-shkurtër
	Rikthimi i gjendjes	I kthyeshem

Gjenerimi i mbetjeve inerte gjatë fazës ndërtimore është një nga ndikimet negative më shqetësuese, për shkak se kompania zhvilluese duhet ti menaxhojë ato.

Si masa parandaluese për ndikimet e ushtruara mbi toke janë:

- Ndikimet të cilat mund të shkaktojnë fenomenin e erozionit gjatë fazës ndërtimore të projektit mund të reduktohen duke përcaktuar ndjeshmerinë e tokës të zonës së projektit ndaj ketij fenomeni.
- Ndikimet të cilat mund të shkaktohen gjatë fazës ndërtimore të projektit mund të reduktohen duke përdorur makineri të teknologjive të reja, duke i mirëmbajtur me servise të herë pas hereshme duke shmangur në këtë menyrë edhe derdhjet e mundeshme të vajrave apo të lëndëve djegese dhe monitorimi i zonës së projektit do të ndihmojë në përcaktimin e gjendjes së saj.
- Ndikimet mund të reduktohen duke kontrolluar edhe mbetjet e prodhua gjatë fazës ndërtimore të projektit nëse në atë zonë do të zhvillohet bujqësia, biznesi i vogël apo i madh dhe turizmi nëpermjet komplekseve të ndryshme.
- Ripërdorimi i nje pjese te mbetjeve nga gërmimet do të shhang grumbullimin e mbetjeve ne sasi shume te medha.

➤ **Vleresimi i ndikimeve ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore**

Vlerësimi i ndikimeve që lindin gjatë ndërtimit dhe operimit të projektit mbi ujrat sipërfaqesore dhe nëntokësore realizohet me vlerësimin e ndryshimeve hidrologjike në zonën e projektit.

Ndikime te shkaktuara nga ndryshimet ne cilesine e ujrave siperfaqesore

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit

Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndikime te shkaktuara nga ndryshimet ne cilesine e ujrale siperafaqesore	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I mesëm
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat-mesem
	Rikthimi i gjendjes	Pjeserisht i kthyeshem

Parashikohet që gjatë ndertimit ujrat gjatë rrjedhes do të jenë të turbullta për shkak të punimeve të ndryshme. Cilësia ekologjike e ujrale parashikohet që të vlerësohet si e "mirë" gjate fazës ndertimore dhe parashikohet që nuk do të ndikoje ndjeshëm në popullatat makroverteber.

Ndikimet në ekologjinë ujore

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndërhyrja në rregjimin e lumbit	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I Madh
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat-gjate
	Rikthimi i gjendjes	Pjeserisht i kthyeshem

Nga projekt "Hec Cerenec" parashikohen që të ketë ndikime në hidrologjine e lumbit për arsyet e nderhyrjeve në të. Do të ketë crregullime hidrologjike në rrjedhen e poshtme të lumbit.

Ndikimet Pozitive Ne Ujrat Nentokesore

Ndikimet ne ujrat nentokesore dhe ne rrjedhen e poshtme te lumbit

Nuk do te kemi ndikim ne ujerat nentokesore.

Për të parandaluar apo për të zbutur ndikimet e shkaktuara gjatë ndertimit dhe operimit të veprës mbi ujrat nëntokësore dhe sipërafaqesore mund të propozohet si mase zbutëse:

- Hartimi i një plani menaxhimi të mbetjeve të ngurta gjatë fazës ndërtimore të projektit.



Vleresimi i Ndikimeve Mbi Karakteristikat Biotike

Me termin **karakteristike biotike** përcaktojmë ekosistemet e faunes dhe të florës të zonës së projektit, e cila gjate fazes ndërtimore mund te ndikohen dhe te prishet ekuilibri i ekosistemeve, si rrjedhoje mund të rrezikohen edhe lloje të florës dhe të faunës.

Në perjithësi, ndikimet e drejtëpërdrejta, gjatë fazës ndërtimore të projektit mbi florën dhe faunën klasifikohen në:

1. “Konfiskim” të mjedisit natyror (vendet e depozitimit të lëndëve të para dhe grumbullimi i mbetjeve të ndryshme) ne te cilin do te kryhen punimet mbrojtseze.
2. Kryerja e punimeve ne zona teper te ndjeshme te ekosistemit.
3. Mundesa e aksidenteve të ndryshme gjatë fazës ndërtimore të projektit.
4. Largimi i kafsheve nga vendodhja e foleve, për shkak të zhurmave të shkaktuara gjatë lëvizjes të makinave.

➤ Ndikimet e shkaktuara nga emetimi i gazeve dhe pluhurave mbi floren

Gjatë fazës ndërtimore per shkak të levizjes së makinave dhe fuksionimi i makinerive të ndryshme do të ketë emetime të gazeve ndotës dhe pluhurit në atmosferë. Si rrjedhojë pluhuri dhe grimcat do të akumulohen mbi sipërfaqet e gjetheve duke shkaktuar në këtë mënyrë ndikime në proces fisiologjike të bimëve, frymemarrije dhe fotosintezë.

Ndikimet e shkaktuara nga emetimi i gazeve dhe pluhurave mbi floren

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndikimet e shkaktuara nga emetimi i gazeve dhe pluhurave mbi floren	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I vogel
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat mesem
	Rikthimi i gjendjes	I kthyeshem

Si masa zbutese ndaj ndikimeve të shkaktura gjatë fazës ndërtimore mbi florën, rekomandohen masat e mëposhtme:

- Përdorimi i makinave dhe makinerive të teknologjive më të mira dhe kryerja e serviseve në mënyrë rigorozë.
- Marja e masave gjate levizjes se makinave në mënyrë që të shmangen pluhurat e shkaktuar nga lëvizja e tyre.



➤ Vleresimi i Ndkimeve Mbi Faunen

Ndkimet E Shkaktuar Nga Zhurmat, Pluhuri Dhe Nga Levizja E Makinave Mbi Faunen

Në përgjithësi, zhurmat dhe zhvillimi i punimeve të projektit, lëvizja e makinave do të jenë faktorët që do të ndikojnë në llojet e faunës së zonës dhe si përfundim edhe zhvendosjen e tyre në zona të reja.

Ndkimet E Shkaktuar Nga Zhurmat, Pluhuri Dhe Nga Levizja E Makinave Mbi Faunen

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndkimet e shkaktuar nga zhurmat, pluhuri dhe nga levizja e makinave mbi faunen	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit Kohezgjatja e ndikimit Rikthimi i gjendjes	I Madh Afat gjatë Pjeserisht i kthyeshem

Zvaraniket-Amfibet: Gjatë fazës ndërtimore për shkak të humbjes së habitatit natyror të tyre do të ndodhë zhvendosja në zona të reja të cilat do të jenë të pershtatshme për të përbushur nevojat ushqyese dhe folezimit të popullateve të zvaranikëve dhe të amfibëve.

Si masa zbutese që duhen ndërmarrë për të minimizuar sa të jetë e mundur ndikimet e shkaktuara nga faza ndërtimore e projektit përshkruhen si më poshtë:

- Për të reduktuar sa më shumë të jetë e mundur prodhimin e zhurmave, propozohen përdorimi i makinave dhe të makinerive të teknologjisë së fundit, kryerja dhe ruajtja e programit të servisit të tyre. Ulja e shpejtësisë së makinave në menyrë që të shmanget sa më shumë zhurmat dhe pluhurat në akset rrugore.


➤ Vleresimi i Ndkimeve Ne Peisazhin E Zones Se Projektit

Vleresimi i ndikimeve te shkaktuara gjate zbatimit te projektit ne paisazhin e zones mund te realizohet ne menyre indirekte duke percaktuar ndryshimet ne parametrat e nivelit te nderhyrjes ne paisazhin e zones, ndjeshmerine optike, shumellojshmeria e paisazhit, niveli i ndjeshmerise dhe te vetise se pershtatjes te paisazhit.

Me termin niveli i nderhyrjes nenkuptojme llojin dhe permasat e ndryshimeve ne njedisin natyror.

Si ndjeshmeri optike nenkuptojme nivelin e pranueshmerise ose mundesine qe mund te kete paisazhi per te harmonizuar ndikimet e shkaktuara nga projekt.

Si shumellojshmeri te paisazhit nenkuptojme ndryshimin e paisazhit dhe llojshmeria e pamjeve vizuale.



Masat parandaluese

Masat parandaluese per te shmangur apo per te minimizuar ndikimet qe do te lindin nga zbatimi i projektit do te perqendrohen ne masat rehabilituese ne menyre qe projekti te bashkejetoje ne nivele sa me te mira me mjedisin natyror.

➤ Vleresimi i Ndkimeve Ne Mjedisin Atmosferik

Vleresimi i ndkimeve ne mjedisin atmosferik realizohet duke vleresuar cilesine e ajrit i cili mund te ndikohet nga emetimet e gazeve ndotes, pluhurave dhe ererave te pakendeshme. Nivelet e ndotjes atmosferike nuk duhet te jene mbi normat e lejuar nga legjislacioni shqiptar. Ndkimet mbi mjedisin atmosferik dhe mbi shendetin e njeriut te shkaktuara gjate fazes ndertimore, kufizohen kryesisht ne zonen e projektit.

➤ Ndkimet Mbi Shendetin E Njeriut

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndkime mbi shendetin e njeriut	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I vogël
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat Mesem
	Rikthimi i gjendjes	I Kthyeshem

➤ Ndkimet Mbi Shendetin E Njeriut

Nga levizja e makinave dhe fuksionimi i makinerive te ndryshme gjate fazes ndertimore te projektit, do te ndotet atmosfera e zones se projektit nga perqendrimet e gazeve qe emetohen, sic eshte monoksidi i karbonit (CO), oksidet e azotit (NOX), dioksidi i karbonit (CO2) dhe nga prania e grimcave ne atmosfera. Nga oksidet e azotit (NOX), ato te cilat emetohen gjate fuksionimit te makinerive te ndryshme jane NO dhe NO2.

Nga levizja e makinave dhe nga fuksionimi i makinerive te ndryshme emetohen ne atmosfera grimca te permasave nga PM 2 deri ne 10 pm.

Per te parandaluar keto fenomene ne mjedisin atmosferik propozohen keto masa (Koutsos, 2008):

Lendet djegese: permisimi i cilesise te lendeve djegese, perdonimi i llojeve alternative te lendeve djeges, ndergjegjesimi per perdonimin e alternativave te ndryshme per lendet djegese.

Makinat: Perdonimi i makinave te teknologjive te fundit te cilat jane te bazuara ne teknologjite miquesore ndaj mjedisit duke emetuar sasi me te vogla ndotesish ne atmosfera dhe qe perdonin si lende djegese gaz apo alkol, kontroll dhe servis i rregullt i tyre.

Fluksi i levizjeve: Menaxhim i levizjeve, programim i orareve te levizjes se makinave dhe sinjalizimi i infrastrukturies.



➤ Vleresim Te Ndkimeve Ne Mjedisin Akustik

Vleresimi i ndikimeve te cilat mund te shkaktojne ndryshime ne nivelet e lejuara te zhurmave mund te realizohet duke vleresuar nivelet e zhurmave te shkaktuara gjate fazes ndertimore duke e krahasuar me nivelet e zhurmave para fazes ndertimore.

Ligjislacioni European ka percaktuar nivelet e lejuara te zhurmave qe prodhohen gjate ndertimit te veprave teknike nga levizja apo fuksionimi i makinerive te ndryshme (Direktiva e EK 79/113/EK/19.12.78, 81/1051/EK/30.12.81, 84/532/EK/19.11.84 e cila percakton nivelet e lejuara te shkarkimeve akustike nga makinerite ne nje kantier ndertimi)

Duke u referuar referencave te ndryshme, zhurmat jane ne nivele me te larta gjate fazes ndertimore dhe jane te ndjeshme ne zonen e projektit.

➤ Ndkime Nga Rritja E Ndotjes Akustike Te Shkaktuara Nga Dridhjet Dhe Germimet

Pershkrimi i ndikimit	Kriteret e Vleresimit	Vleresimi i ndikimit
Ndkime nga rritja e ndotjes akustike	Lloji	Negativ
	Vlera e ndikimit	I vogël
	Kohezgjatja e ndikimit	Afat Shkurter
	Rikthimi i gjendjes	I Kthyeshem

Si masa zbutese te ndikimeve ne mjedisin akustik te zones se projektit gjate fazes ndertimore parashikohen te jene:


- Perdorimi i modeleve te reja te makinave dhe te makinerive te cilat jane te pajisura me certifikate te BE per zhurmat, do te ndikojne ne uljen e nivelit te tyre.
- Ndalimi i punimeve apo te levizjeve te makinave gjate oreve te pushimit per banoret e zones. Ruajtja e niveleve te xhurmave te cilat percaktohen nga legjislacioni.
- Hartim dhe zbatim te nje plan-zbatimi te punimeve, i cili percakton sakte intervalin kohor te zbatimit te punimeve te cilat shkaktojne zhurme.

Ndkime te Tjera ne Mjedis:

Ndkimi i linjes se transmetimit te energjise elektrike

Varjanti i lindhjes ne N/Stacionin 110/35/20 kv, Shupenze do ishte i pershtatshem nga ana ekonomike, pasi ne kete N/Stacion ka tension 20 kV, por eshte me pak i sigurte sepse N/Stacioni 110/35/kV Gjorice –Lubalesh eshte me skeme me te sigurte dhe me elastike.

Ne linje do te montohen shtylla beton-arme te centrifuguara 10-12 ml, me armature te perforuar te certifikuara. Per shtyllat nuk do te behen llogaritje te vecanta pasi ato do



te merren te certifikuara dhe qe plotesojne kushtet e mbilartesimit ne vertikalitet dhe kane rezeve te mjaftueshme soliditeti ne kondita te pafavorshme (avarie) te perdoreshme per linja ajrore 20 KV. Te gjitha shtyllat ndermjetese duhet te ruajne vertikalitetin e tyre pa asnje shmangje dhe duhet te fiksohen ne grope me gure e dhe te ngjeshur ndersa per shtyllat kendore do te kete edhe beton te markes M - 150. Do marrim 56 cope shtylla ndermjetese dhe 10 shtylla kendore, fundore dhe ankerore.

Ne percaktimin e traktit te linjes jane marre ne konsiderate:

- Traseja e linjave te transmetimit te jete e qendrueshme nga pikpamja gjeologjike; shmangja e zonave me rreshqitje qe mund te ndikojne ne daljen nga puna te linjes dhe rrjedhimisht te hidrocentralit
- Marrja ne konsiderate e klimes se zones ne percaktimin e parametrave konstruktive vecanerisht te shtyllave.
- Pozicionimi i aksit te linjave ne terren larg zonave te banuara, banesave apo qendrave social-kulturore, per shmangjen e aksidenteve dhe minimizimin e efekteve te fushave elektrike ne banoret e zones.
- Evitimi i kalimit te traktit te linjave ne toka te punuara dhe pyje.
- Lehtesine ne ndertimin e linjave dhe ne mirembajtjen e saj duke shfrytezuar rrjetin ekzistues rrugor.

Ndikimet :

- Pas ndertimit te bazamentit dhe shtylles, te tensionit te larte, siperfaqja e prekur nga punimet do te rehabilitohet duke u kethyer ne gjendjen fillestare.
- Aktiviteti i transportimit te materialit shoqerohet me prodhim zhurme, per shkak te punes se makinerive .Ky ndikim ka karakter te perkohshem ne dite dhe muaj gjate kohes se punes.
- Ndikim tjeter i mundshem do te jete prodhimi i pluhurit nga aktiviteti i germimit, te bazamenteve, dhe gazeve te krijuara nga mjetet motorike. Sasia e pluhurit te krijuar dhe gazeve te cliruara do te jete ne sasi dhe kohe te limituar.
- Remonti dhe sherbimi ndaj difekteve te mundshme ne nenstacionin elektrik mund te shoqerohet me ndonje prodhim mbetjesh te ndryshme .
- Transformatoret me vaj dhe pajisjet e tjera elektromekanike jane prodhime te standartit europian. Nga pikepamja e mbrojtjes se mijedisit jane konstruktuar si paisje te sigurta.
- Projekti i linjes elektrike ,i krasahuar me normat e perdonura ne vendet e BE- se dhe rekomandimet e OSH-se eshte parashikuar me vlera te fushes elektromagnetike shume poshte kufijve te rekomanduar.Ndikimi i faktorit elektromagnetik mund te jete vetem ndaj personelit te punes qe eshte i ekspozuar.
- Fusha elektrike e gjeneruar varet kryesisht nga tensioni i linjes. Varet gjithashtu nga lartesia e perçellsave nga toka dhe zvogelohet me rritjen e lartesise. Keshtu zonat qe duhen mbrojtur me shume jane ato ku lartesia e perçellsave nga toka eshte minimale dhe nivelet e fushes te larta.
- Efekti i veprimit te ketyre ngarkesave eshte ne funksion te moshes se njeriut, pandaj rekomandohen qe te punesozen personel i maturuar biologjikisht te te



cilet efekti i fushes elektromagnetike eshte minimal dhe jo me shtangesime bioelektrike.

- Impakti ne mjedisin human nga rrezatimet

Impakti nga ndertimi : gjate procesit te punes se ndertimit ne terren nuk do te ndikohet nga rrezatimi i fushes elektromagnetike

Impakti nga operimi dhe mirembajtja : gjate operimit dhe mirembajtjes ndikimi mbi mjedisin human do te merret ne konsiderate.

Ne lidhje me rrezatimin jonizues te linjave elektrike, intesiteti i fushes elektrike ne nje lartesi 1.8 m nga siperfaqja e tokes,nuk e kalon 5 kV/m dhe me 1kV/m jashte zones buferike te sigurise, matje te tjera te detajuara dhe perllogarritje te sakta do te jene te nevojshme te realizohen per te mbrojtur mjedisin social dhe natyral.

Ndikimi ne mjedis nga hapja e rrugeve te reja ndihmese ne rast se do te jete e nevojshme :

- Mund te shkaktohet erozion gjate fazes se punimeve ,per te shmangur kete rrezik duhet nje kontroll i vazhdueshem i punimeve.
 - Ti kushtohet vemandje evitimit te ndotjes se ujerave nentokesore nga ndotesit e prodhuar kryesisht nga automjetet gjate punimeve
 - Gjate sistemimit te rruges do te kete krijim te pluhurave , te cilat mund te shmangen me ane te lagies se vazhdushme te siperfaqes.
 - Zhurma mund te shkaktoje shqetesime per banoret e fshatit me te afert por vetem gjate punimeve te pjeses se rruges me afer fshatit.
- Zona ku do te kaloje rruga do te jete zone e zhveshur nga bimesia , pra nuk do te kete prerje te bimeve gjate punimeve.
- Persa i perket volumeve te germimeve nga hapja e rrugeve ndihmese , ato jane paraqitur tek pjesa e menaxhimit te mbetjeve inerte.

Ndikimi në popullsi.


Vepra hidroenergjiteke e propozuar nuk do t^e sjellë asnje ndryshim n^e vendosjen, shpërnguljen e popullsisë. Raporti i projektit si plan vendosje me komunitetin bën q^e vepra t^e mos influencoje n^e demografinë komunitare. Por si rezultat i shtimit t^e punësimit n^e këtë projekt, komuniteti do t^e përfitoj t^e ardhura financiare, gjë q^e do t^e ndikojë n^e mirëqënen e tij. Nga ana tjetër projekti do t^e ndikojë pozitivisht n^e furnizimin me energji t^e popullatës.

Ndikime n^e qarkullim dhe infrastrukturë.

Praktikisht projekti nuk do t^e shkaktojë ndryshime n^e mënyrën e sotme t^e qarkullimit t^e njerezve dhe t^e mjeteve. Projekti gjithashtu nuk do t^e ndikojë n^e shtimin e rreziqeve n^e qarkullim. Ndikim n^e qarkullim do t^e jetë vetëm shtimi i fluksit t^e makinave gjatë ndërtimit, por kjo do te influencoje n^e mirembajtjen e rrugës ekzistuese dhe strukturimin e disa segmenteve rrugure.

Ndikime n^e sistemin energjitik.

N^e sistemin energjistik lokal dhe atë kombëtar ndikimi i këtij projekti do t^e shoqërohet me impakt mjedisor pozitiv. Kjo pasi do t^e shtohet n^e mënyrë t^e konsiderueshme sasia e energjisë së prodhuar duke përmiresuar furnizimin me energji elektrike t^e fshatrave te kesaj zone.



Ndikimi në trashëgimine kulturore.

Fakti që në segmentin e ndërtimit të këtij projekti nuk ka ndonje objekt të trashëgimisë kulturore, arkeologjike, impakti negativ i këtij projekti në këtë drejtim nuk egziston.

Ndikimi në rregjimin e mbetjeve.

Gjate aktivitetit do te mbahen parasysh kerkesat e ligjit:

Ligj nr. 156 datë 10.10 2013 Per disa ndryshime ne ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM:

VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”

Ne veprimtarine shfrytezuese te vepres hidroenergjjitike do te kete mbetje te ngurta qe rezultojne nga konsumi i personelit ne vendin e punes. Keto mbetje jane te pa perfillshme dhe nuk krijojnë asnje problem mjedisor. Por personeli i punes duhet te tregoste kujdes ne hedhjen e tyre, per te mos prishur estetiken e mjedisit perreth h/centralit. Gjithashtu do te kete mbetje dhe rrjedhje vajrash lubrifikimi te cilat duhen trajtuar me kujdes per te mos u derdhur ne rrjedhen e perroit, por te grumbullohen ne dekantor dhe te largohen ne vende te pa filtruveshme.

NDIKIMET POZITIVE

- Efekti kryesor pozitiv do te jete prodhimi i energjise elektrike se rrinovueshme, si energji e paster pa ndotje ne mjedis.
- Ne fazën e ndertimit te veprave do te kete hapje te vendeve te reja te punes.
- Ndertimi i hidrocentralit do te permiresoje ndjeshem kushtet e jetesës se banoreve te zones.
- Ngritura e kantierit te ndertimit do te shoqerohet me hapjen dhe zhvillimin e aktiviteve sociale dhe ndihmese.
- Permiresim te treguesve sasiore dhe cilesore te furnizimit te zones dhe te vendit me energji elektrike.
- Pritet te kete permiresim te sistemit te sherbimeve dhe potencialeve rekreative te zones.
- Largimi mbetjeve te ngurta nga perroi do te permirsoje cilesine e ujit.
- Zona do te mbetet me po ato funksione per te cilat eshte e destinuar dhe nuk do te kemi ndryshim te ketij destiancioni.



4. PËRSHKIMI PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE.

Ndotje më të rëndësishme që mund të shkaktohen paraqiten ne tabelën e mëposhtme.

Lloji i ndotësit	Burimi i prodhimit	Ndotimi në ambjentin natyror dhe antropogjenez
Pluhuri	Punimet e gërmimit, transporti i materialeve, përgatitjet e betonit, lëvizjet e mjeteve.	Trupëzat mikroskopikë ndikojnë në frysëmarrje, shkaktojnë sëmundje të rrugëve të frysëmarrjes dhe në mushkri. Gjithashtu shkaktojnë ndikim negative edhe në shikim. Ndikimet e pluhurave në përgjithësi varen si nga madhësia e tyre (sa më të vogla të jenë aq më të rrezikshme janë), por edhe nga përbërja e tyre kimike. Pluhuri me madhësinë e trupzave më të vogël se $5 \times 10^{-6} \mu$ shkakton dëmtim të aparatit frysëmarrjes.
Lëngje/tretës mjeteve	Proçeset e mirëmbajtjes së mjeteve	Toksike për organizmat ujore.
Bojrat	Proçesi i lyerjes ose pastrimi i paisjeve të bojës.	Përqëndrime të mëdha shkaktojnë rritje të COD shtim të PH, gjë që shkakton toksifikimin e organizmave ujore.
Nënprouktet nafte	Procedurat e furnizimit të mjeteve me karburant.	Toksik për organizmat ujore dhe nëntokësore.
Mbeturina të ngurta	Rregullim fillestar i sipërfaqes së truallit, punimet e ndërtimit, etj.	Një grumbullim i pa kontrolluar i këtyre mbeturinave ka mundësi të shkaktojë ndotje të konsiderueshme të ujit me llumra.
Zhurma	Punimet e gërmimit, lëvizja e mjeteve, punimet e ndërtimit.	Ndikon keq në sistemin e dëgjimit tek njeriu si dhe shëndetin psikologjik dhe trupor të tij.

Tabela 1: Ndotjet me te rendesishme te shkaktuara nga projekti

5. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA.

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale e projektit teknik, shfrytezimin e kemi konceptuar ne dy faza:

Faza e pare.


Pergatitjen e raportit te fizibilitetit, dhe marrjen e koncessionit per shfrytezimin e rezervave ujore per HEC Cerenec

Faza e dyte.

Ndertimi i vepres hidroenegjitike, shfrytezimin e tij dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Bazuar ne keresen e vete subjektit, rezervave te shfrytezueshme, kapacitetit prodhues te HEC-it, prodhimi vjetor ne objekt eshte parashikuar

E=9.751.663kwh/vit.



Kohezgjatja e ndikimeve kryesore perkon me kohezgjatjen e ndertimit te veprave.

Kohëzgjatja e ndërtimit të veprës do të jetë 21 muaj nga data e marrje së lejes së ndërtimit.

Sipërfaqja që do të preket do të rehabilitohet paralel me kohën dhe fazën e ndërtimit.

Grafiku i Punimeve - Eshte vendosur bashkengjitur ketij raporti.

6. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË.

Shtrirja hapesinore e ndikimit negativ ne mjedis ka relativisht një rreze te ulet nga vendi ku do te ndertohet hidrocentrali. Ndikimet kryesore ne hapesiren ku do te ndertohet ndahet ne dy siperfaqe, bazuar dhe ne llojin e ndikimit:

➤ **Hapesira ku do te ndertohet vepra, ndikimet negative.**

Ndikimi negativ ne kete siperfaqe do te jete kryesisht ne germime dherash per hapjen e themeleve te veprave. Rreth 90% qe do te dalin nga germimet do te rifuten ne pune pasi do te sherbejne si material mbushes per kanalet dhe pjeset anesore te mureve te veprave, ndersa pjesa tjeter do te hidhet brenda hapesires ndertuese te vepres ne vende pa interes publik dhe ne gropat te cila kane nevoje per mbushje gje e cila do te konsultohet edhe me pushtetin lokal te zones. Prerje pemesh dhe zenie te siperfaqes se gjelbert mund te mos kemi pasi te gjitha veprat shtrihen ne zone qe karakterizohet nga zone zallishte me pak hapesira te gjelbera.

➤ **Hapesira jashte siperfaqes ku do te ndertohet vepra, qe do kete ndikime negative.**

Jashte siperfaqes se ndertimit te vepres, ndikime negative do te kemi vetem ne zhurmat, ngritja e pluhurit dhe vibrimet te cilat i permendem dhe me siper per marrjen e masave te tyre. Ndikimi i tyre do te jete brenda normave te lejuar dhe oraret e punimeve do te zgjidhen ne menyre te tille qe te mos kete shqetesime per banoret e zones.

Zonat e banuar (fshatrat) nga vendetimi i vepres kane një largesi te konsiderueshme keshtu qe zhurmat, vibrimet dhe pluhuri do te jene ne masa te paperfillshme.

Zbatimi i projektit per ndertimin e HEC-it Cerenec do te kerkoje shfrytezin e burimeve natyrore e per rrjedhoje operacionet qe do te kryhen ne fazen e ndertimit te tij do te kene ndikime ne mjedisin prites. Analiza e kryer ne kete raport ne lidhje me ndikimet e mundshme ne mjedis te projektit tregon se ato jane te kufizuara dhe pa pasoja te rendesishme dhe te pakthyeshme. Po keshtu edhe kohezgjatja e ndikimeve qe mund te konsiderohen te rendesishme eshte e limituar.

Vlen te ritheksohet se projektet e prodhimit te energjise me ane te HEC-it, te cilet perdonin burime te rrinovueshme, jane ne listen e rekomandimeve dhe prioriteteve te politikave mjedisore sot ne rrafshin global pasi energjia e prodhuar ne kete menyre quhet ndryshe energji e paster. Nga analiza del se bilanci i ndikimeve negative te veprimtarise dhe atyre pozitive eshte ne favor te ketyre te fundit. Ndertimi dhe venia ne shfrytezim e ketyre hidrocentraleve do te ndihmonte ne një mase te konsiderueshme zgjidhjen e problemit te furnizimit me energji elektrike ne zone duke siguruar prodhimin e energjisë se paster nga burime te rrinovueshme.

**7. MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE
MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË
SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME SI DHE KOSTOT
FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN.**

Gjate kryerjes se operacioneve te ndertimit do te kete krijim te mbetjeve inerte (dhera, masa shkembore) si rezultat i punimeve te ndryshme.

Keto klasifikohen si mbetje ndertimore nese lind nevoja e depozitimit apo zhvendosje nga zona ne nje siperfaqe tjeter. Shoqeria qe do te zbatoje projektin duhet te planifikoje qarte menyren e administrimit te inerteve per te menjanuar mundesine e depozitimit te tyre per gjate brigjeve te perroit. Nje pjesa do te perdoret per mbushjen e kanaleve, pjesa qe mbetet do te depozitohet ne vende te vecanta per te cilen investitori do te bjere dakort me organet e pushtetit vendor. Kompania do te marre te gjitha masat per depozitimin e tyre ne vende te posacem, te cilat ne perfundim do te rehabilitohet nga pikepamja mjedisore se bashku me siperfaqet e tjera qe do te mbushen. Megjithate paraprakisht kemi percaktuar ne harte gjashte vende te mundshem per depozitimin e ketyre mbetjeve (harta e vendosjes se tyre eshte bashkengjitur ketij raporti ne format A3).

Nga nje llogaritje paraprake kemi keto volume germimesh:

Volumet e germimeve per Hec Cerenec	
	Volumi (Njesia m³)
Vepra e Marrjes	54255
Basen Presioni	6180
Boks Derivimi	46050
Kulla e Ekuilibrit	1600
Godina e Centralit +Rruge Ndihmese	1015
Totali m³	109100

Tabela 2 Volumet e germimeve per Hec-in Cerenec

Volumi total i germimeve eshte 109100 m³. Nga keto dhera 10% e tyre do te shperndahen ne siperfaqe depozitimi me lartesi deri ne 3.5 m ndersa 90% e tyre do te perdoren per mbushje. Dherat do hidhen ne nje distance mbi 100-200 m larg shtratit te lumit si detyrim i ligjit 111/2012.

Nga llogaritjet del qe: Vtot x 90% = 98190 m³

Ndersa: 109100 m³ - 98190 m³ = 10910 m³ do te hidhen ne 6 pozicione te ndryshme me siperfaqe perkatesisht :

S1=286 m², S2=571 m², S3=514 m², S4=571 m², S5=428 m², S6=746 m²,

Me poshte po jepim tabelen e siperfaqeve dhe volumeve qe do te zene inertet e shperndara, ku pozicioni i tyre eshte teper i favorshem si nga ana e mjedisit te cilat jane zgjedhur te hidhen mbi tarraca te zhveshura nga bimesia dhe pa interes publik por edhe nga ana ekonomike sepse keto tarraca ndodhen afer veprave te HEC-it.



Tabela e volumeve dhe siperfaqeve te depozitimit te inerteve per Hec-in Cerenec				
		Sip(m ²)	Lartesi mes (m)	Volumi (m ³)
HEC “CERENEC”	sip 1	286	3.5	1000
	sip 2	571	3.5	2000
	Sip 3	514	3.5	1800
	Sip 4	571	3.5	2000
	Sip 5	428	3.5	1500
	Sip 6	746	3.5	2610
Totali		3116	3.5	10910 m ³

Tabela 3: Tabela e volumeve dhe siperfaqeve te depozitimit te inerteve per Hec-in Cerenec

Projekti parashikon sistemimin e inerteve duke i ndare ne siperfaqe dhe volume te tilla duke respektuar ligjin 111/2012” Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore”.

Mbas ngjeshjes, nivellimit siperfaqja e sheshit te krijuar nga germimet do te shkriferohet dhe do te mbillet me fare bari autoktone te zones. Kjo bimesi duke qene me sistem rrenjore xhufkore do te luaj rolin e stabilizuesit biologjik te mases se dheut ne fazen e pare te riaftesimit te tokes dhe fillimin e zhvillimit te proceseve fillestare te formimit te struktura se tokes dhe raportet ajer-uje te aggregateve toksore dhe poreve.

➤ **Ne vijim po prezantojme masat rehabilituese per Hec-in :**

- Punimet e sistemimit te dheut qe do grumbullohet nga germimi ne Hec-in

Dherat qe do te gjenerohen nga germimet e ndryshme do te sistemojen ne nje vend te caktuar per tu perdorur nje pjese per rehabilitimin e shesheve te germuara. Kjo mase dherash te germuar do te ngjeshet dhe do te mbillet me shkurre dhe bimesi vendase ne menyre qe fenomeni errodues nga shirat dhe ujerat te parandalohet, po ashtu bimesia qe duhet te mbillet duhet te jete autoktone per te mos thyer pejsazhin karakteristik te zones.Keto punime do kryhen ne mbyllje te cdo procesi operacional sipas planit te punimeve respektive.

- Sistemimi i inerteve nga germimet ne sheshin e ndertimit te Hec-it

Subjekti do te sistemoje dherat me permasa te ndryshme me qellim shtratimin strukturor mbi sheshet e ndertimit qe do te mbeten bosh dhe mbi keto do te hidhet dhe.



- Hedhja e dherave ne sheshet e ndertimit te mbetura bosh.

Dheu i grumbulluar gjate hapjes se shesheve te ndertimit do te sistemohet ne ato pjese te sheshit qe nuk prishin pune gjate ndertimit te veprave te Hec -it dhe ne rastin konkret kanali i derivacionit do te mbulohet ne te gjithe gjatesine e tij pasi do te jete i mbuluar.Kjo me qellim qe shpatet e formuara nga germimet te risistemohen gje e cila ndihmon edhe kanalin ne jetegjatesine e tij, ne temperaturen e ujit brenda ne kanal, si dhe keto siperfaqe te cilat do te risistemohen do te mbillen me bimesi vendase cka ne perfundim te tij nuk do te kete ndikim ne impaktin vizual.Ne rrekete e vogla do te krijohen struktura drenazhuese me gure te vegjel per te minimizuar fluksin e levizjes se dherave ne drejtim te shtratit te lumenit duke ulur shpejtesine e rrjedhes.

- Punimet e maturimit te shtratit te dheut.

Para se te realizohet procesi i mbjelljes se terrenit te krijuar me bimesi vendase duhet qe dheu i hedhur te maturohet ne menyre qe te ofroje kushte te pershtatshme per mbjelljen e fidaneve. Fidanet duhet te mbillen ne presence te specialistit pyjor dhe atij te Agjencise Rajonale Mjedisore (ARM) ne menyre qe te respektohen distancat dhe varietetet e fidaneve qe do mbillen sic jane ato vendase si pisha .

- Mbjellja e fidaneve

Ky proces do te behet mbas nje periudhe e cila rezulton me kriimin e kushteve te pershtateshme per mbjelljen e fidaneve. Kjo behet mbasi te kete perfunduar levizja e dherave nga germimet, mbyllja e fazes ndertimore per objektin dhe risistemimi i dherave perfundimtare duke krijuar mundesine e stabilizimit te dherave dhe mbjelljen e fidaneve perpara periudhes se shirave te pare.Mbjellja e fidaneve rekomandohet ne fund te vjeshtes ose ne dimer ne kohen e pyllezimeve.Rekomandohet te mbillen **fidane autoktone te zones**.

Siperfaqja e shesheve te depozitimit qe do te rehabilitohen dhe do te mbillen do te jete S1+S2+S3 +S4+S5=afersisht 3116 m^2 , ku sipas skemes se pyllezimit (te pishes) $2x2$ kemi : $3116 \text{ m}^2 / 4 = 779$ fidane. Siperfaqja e tubacioneve te turbinave qe do te rehabilitohet do te jete $1830 \times 3.2 = 5856 \text{ m}^2$, gjate kesaj siperfaqeje nuk do te perdoret skema e pyllezimit $2x2$ por do te vodosim bime cdo 6 m^2 dhe kemi : $5856/6=976$ fidane , pra ne total afersisht 1755 fidane, po marrim 1760 fidane. Procesi per sistemimin e tarracave dhe mbjelljen e pemave do te filloje mbas perfundimit te ndertimit te vepres dhe do te zgjasit 1 vit.

Preventivi i rigjenerimit te mjedisit:

Hapje gropash	1760 copë x 200 lekë/copë	352000 lekë
Blerje fidanash, transport etj.	1760 copë x 200 lekë/copë	352000 lekë
Mbjellje, plehërim	1760 copë x 100 lekë/copë	176000 lekë
Totali i preventivit		880000 lekë



8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Qëllimi kryesor i VNM është të identifikojë mënyrat se si projekti i propozuar mund të ndryshohet, transformohen për të zbutur efektet e tyre në mjedis. Në mënyrë të thjeshte, zbutja e ndikimeve te mjedisit është konsideruar të përfshijë ndonjë veti të një projekti të propozuar, i cili shmang, zvogëlon ose riparon efektin e saj negativ mbi mjedisin apo siguron përfitime mjedisore. Masat zbutëse përfshijnë aspektet fizike të projektit apo mënyrat sipas të cilave ai është ndërtuar apo operon. Ato gjithashtu mund të përfshijnë apo përjashtojnë veti të projektit, për shembull, komponentë të projektit që mund te shmangen për të reduktuar ndikimin e tij apo karakteristikat shtesë që janë shtuar për të rritur përfitimet mjedisore.

Ekipi i VNM ka patur një rol jetik në këtë proces. Detyra e tyre ishte identifikimi, kur një projekt mund të ketë ndikime të rendësishme mbi mjedisin dhe ka bashkepunuar me zhvilluesin për të identifikuar mënyrat nëpërmjet të cilave ato mund të reduktohen. Ky ka qene një proces i përsëritur dhe ka nisur qe në fazë të hershme te hartimit të projektit.

Zakonisht nuk është e mundur të zbutet çdo ndikim i një projekti, por puna e ekipit të VNM është që të punojë me zhvilluesin e projektit për të vendosur se çfarë është e mundur dhe e përballueshme në kontekstin e zhvillimit të propozuar.

Hierarkia e masave zbutëse

‘Hierarkia e zbutjes’ është e dobishme në identifikimin e rregullit sipas të cilit duhet të konsiderohen masat. Hierarkia bazohet në parimin se është më mirë të parandalohet gjenerimi i ndikimit në burim, se sa të përpinqemi t'i përgjigjemi efekteve të tij pasi ndikimi ka ndodhur:

- Përqasja e preferuar e zbutjes është të hartosh një projekt duke shmangur tiparin që të drejton tek ndikimi.
- Nëse ndikimi nuk mund të shmanget, hapi tjetë është ta minimizosh atë, p.sh.ta reduktosh atë që të bëhet sa më i vogël të mundet zvogëlimi në vend.
- Sapo ndikimi të jetë reduktuar sa më shumë të jetë e mundur në burim, reduktime të tjera mund të arrihet nga zvogëlimi tek receptori.
- Nëse efektet e padëshiruar mbeten akoma, opzioni tjetër është të konsiderohet nëse ka mënyra të riparimit të dëmit pasi ai ka ndodhur.
- Nëse ndikimi nuk mund të riparohet, duhet të konsiderohet opzioni i kompensimit për të duke zëvendësuar çfarë ka humbur. Ky kompensim mund të jetë në natyrë (p.sh. duke siguruar një burim të ngjashëm me atë që ka humbur) ose duke siguruar një përfitim tjetër mjedisor.

Hierarkia e zbatuar e masave zbutëse është përbledhur më poshtë:

Hierarkia e masave zbutëse

Shmang në burim

Minimizimi duke e zvogëluar në vend

Minimizimi duke e zvogëluar tek receptori

Riparimi i dëmit

Kompensimi në natyrë

Kompensime të tjera dhe nxitje



Një listë kontrolli e tipeve të masave për të zbutur ndikimet, qe eshte perdonur jepet më poshtë.

Lista e Kontrollit të Opsiōneve Zbutëse

Modifikime të planit të zonës ose strukturave të projektit

Peisazhi brenda dhe jashtë zonës (punimet e tokës dhe mbjellja)

Proçese operimi ose lëndësh të para alternative

Materiale dhe burime alternative të energjisë

Masa për kursimin e energjisë dhe burimeve

Shkallë të reduktuar të aktivitetit, masë më të vogël

Metoda për të reduktuar zhurmën, vibrimin, ndriçimin, rrezatimin çlirimin e energjisë në urim

Bariera dhe ekrane për të fshehur projektin ose për të zgjedhur zhurmën

Masa të marra tek receptori për të reduktuar ekspozimin ndaj ndikimeve p.sh. të shkohshme ose të përhershme, rivendosje, izolim të zhurmës

Modifikime të metodave dhe praktikave të punës, p.sh. metoda alternative ndërtimi

Procedura të emergjencave dhe planeve për në rast aksidentesh, rrjedhjes etj.

Kufizime të orëve të punës

Kufizime të aksesit dhe kontroll i rrugëve

Sigurimi i kompensimit (në mall ose financiar), zëvëndësimi i habitateve, i burimeve të mbitura, sigurimi i përfitimeve të tjera për komunitetin, përmirësimë të pronave

Kërkime në ruajtjen e trashegimise kulturore

Sistemet e menaxhimit mjedisor

Trajnimi i stafit

Monitorimi dhe auditimi

Informimi i komunitetit

Plus

Alternativat Strategjike

Alternativat që lidhen me vend ndodhjen

Skenari pasiv “mos bëj asgje” apo “pa zhvillim”

- TRAJTIMI I RREZIQEVE DHE “NGJARJEVE TË PAZAKONSHME” TË TJERA NË VNM

Vlerësimi i rrezikut ka adresuar tri pyetje themelore:

1. Çfarë mund të shkojë keq?
2. Sa shpesh mund të ndodhe?
3. Cilat janë pasojat për njerëzit dhe mjedisin?

Një numër aktivitetesh esenciale janë të përfshirë në vlerësimin e rrezikut. Këto ndahen në pesë hapa kryesorë:

- Identifikimi i rrezikut;
- Analiza e rrezikut;
- Analiza e pasojave;
- Përcaktimi i rrezikut;
- Vlerësimi dhe Masat Zbutëse.



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

Lloji i Ndikimit	Masat per zbutjen e ndikimit	Komentet mbi efektshmerine e masave
Gjenerimi masave te dherave si pasoje e punimeve te ndryshme inxhinierike	<p>Piketim i sakte i siperaqes ku do te punohet .</p> <p>Perdorimi maksimal i rrugeve ekzistuese</p> <p>Sistemimi i dherave per perdorim ne rehabilitimet e mundshme.</p> <p>Per kryerjen e ketyre operacioneve do te bashkepunohet me organet e pushtetit vendor.</p>	<p>Ndikimi mbahet brenda kufijve te tij natyrale.</p> <p>Minimizohet efekti negative i gjenerimit te mbetjeve inerte.</p>
Emetim zhurmash, gazesh, aromash, vibracioni dhe pluhuri	<p>Kontrolli periodik i makinerive per te siguruar emetim brenda normave te lejuara si per gazet ashtu edhe per zhurmat.</p> <p>Planifikimi paraprak i punes dhe realizimi ne kohe sa me te shkurter.</p> <p>Transporti i mbetjeve dhe lendeve te para per ndertim me kamione te mbuluar.</p> <p>Lagia e herepashershme me uje (veçanërisht ne kohe te thatë) e siperaqeve te punes.</p>	<p>Mbajtja e cilesise se ajrit brenda kufijve normale.</p> <p>Ulet koha e zgjatjes se ndikimit.</p>



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

Shqetesim dhe ngjeshje e pjesshme e shtreses se tokes nga pershtatja e vendparkimeve dhe vendmagazinimeve e dhe nga levizja e automjeteve te transportit	Levizja dhe parkimi i makinerive brenda zonave te caktuara . Percaktimi i vendeve me te pershtatshme per kete qellim.	Mbrojtja e shtreses se tokes nga demtime te panevojshme dhe te teperta.
Erozion i siperfaqeve ku do te zhvillohen punimet ne mot me rreshje	Planifikimi paraprak i punes dhe realizimi i operacioneve ne kohe sa me te shkurter. Hapja e kanaleve perimetrike te thelle sipas gradientit te pjerresise dhe levizjes se mases.	Dobesohet efekti gerryes i shiut ,pra minimizohet mundesia per erozion.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Kontroll dhe testimi periodik i gjendjes teknike te makinerive	Mbrojtja e tokes, ujerave siperfaquesore dhe atyre nentokesore
Ndikimi ne boten e gjalle (flora dhe fauna)	Ndalja e punimeve gjate oreve te nates. Inspektimi para fillimit te operacioneve per te analizuar me kujdes sjelljet e botes se gjalle dhe per te percaktuar momentet e nderprerjes se aktivitetit ne fazat te caktuara te ciklit vjetor te zhvillimit te biodiversitetit, si psh koha e riprodhimit. Pastrimi i pluhurave. Vleresime me te sakta per masat e duhura do te jepen ne vitin e dyte, mbas monitorimit te biodiversitetit ne zone gjate vitit te pare te veprimtarise.	Krijohen kushtet e nevojshme qe kafshet te levizin ne zone, gjuajne dhe riprodhohen Kujdesi do te vazhdoje deri ne celjen dhe levizjen e te vegjelve nga foletë. Krijimi i kushteve per zhvillimin normal dhe riprodhimin e bimeve.



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndkimit ne Mjedis Hec CERENEC

Ndkimi ne pyje ,drure te ndryshem	Ripyllezim, Kompesim	
Ndkim ne hidrologji dhe rregjimin e rrjedhjes.	Ruajtja e rrjedhes ekologjike	
Ndkim ne cilesine e ujit dhe ndotjen.	Kompesim, projekte mbeshtetese	
Perdorimi i Ujit	Kompesim, projekte mbeshtetese	
Mbetjet	Vendosja e konteniereve per hedhjen e mbeturinave dhe depozitimi i tyre ne perputhje me planet lokale te menaxhimit te mbetjeve.	Menjanohet ndotja e mjedisit nga mbetje me natyre te ndryshme.


Tabela 4: Tabele e permbledhur e masave zbutese te ndikimeve kryesore

➤ **Për një përballim sa më efikas të ndikimeve të mundshme në mjedis nga shoqeria investitore kërkohet:**

1. Përdorimi i mjeteve të mirëmbajtura dhe të kontrolluara periodikisht në bazë të kërkesave të firmës prodhuase.
2. Përdorimi i automjeteve të jetë efikas nga ana ekonomike dhe ekologjike, duke evitar lëvizjet e pa nevojshme.
3. Objektet e veprës hidroenergjitet dhe aksesorët gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrethohen dhe të përdoren tabela sinjalizuese për njerëzit.
4. Gjatë punimeve ndërtuese të ndalohet në mënyre kategorike perdorimi i djegjes për çfareolloj arsyje.
5. Është e domosdoshme që personeli i përkohshëm dhe ai definitiv i punimeve të instruktohen mbi regjin e punës dhe mbrojtjen e mjedisit.

➤ **Per te evitar ngjarjet e padeshirueshme dhe aksidentet ne pune duhen marre keto masa :**

Perpilim e miratim i rregullores se brendshme per personelin drejtues e zbatues, duke percaktuar detyrat e pergjegjesite e secilit ne lidhje me sigurine ne pune e mjedis, ne perputhje me kodin e punes e ligjet e tjera ne fuqi.Punesim i nje personeli te kualifikuar, gjate fazes se ndertimit & ne veçanti gjatë shfrytëzimit.Paisje me rregullore te sigurise ne pune, vendosja e tyre ne vende te dukshme, sipas natyres e shkalles se rrezikut gjate fazes se ndertimit e shfrytëzimit te objektit. Zberthim i kartes teknologjike te makineri-paisjeve, radha e venies ne pune te tyre, e afishim ne afersi te tyre ne korniza te rregullta.Kompletim i punonjesve me mjetet e mbrojtjes ne pune, sipas kerkesave ligjore, e ushtrim kontrolli per perdorimin e tyre. Ne veçanti, kujdes duhet te tregohet ne mbrojtjen e punonjesve nga



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

ekspozimi i zhurmave, duke i paisur me mijete mbrojtese sipas kerkesave ligjore per mjedise te tilla pune.

➤ Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis te aktivitetit

Qellimet e monitorimit mjedisor

- Per te vleresuar pasojat e ndotjes se mjedisit tek njerezit
- Studuar bashkeveprimet midis substancave ndotese dhe objekteve mjedisore (vleresohet vecmas kontributi i secilit burim ndotes)
- Per te vene ne veprim procedurat e emergjences ne zonat ku mund te ndodhin raste te rendate ndotjeve
- Per te krijuar nje arkive te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe perdoret ne te ardhmen

Nje program monitorimi duhet te permbaje :

- Vendodhjen e stacioneve te marrjes se mostres
- Kohezgjatja e marrjes se mostrave
- Cfare do te monitorohet
- Ku dhe kur do te monitorohet
- Si do te monitorohet

Objektivat e monitorimit:

- Vleresimi i efikasitetit te pajisjeve per pakesimin e ndotjeve
- Vleresimi nese shkarkimet nga nje burim i vecante jane ne perputhje me normat ose kufizimet perkatese

Monitorimi i burimeve te ndotjes

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e HEC-it eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performance mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Programi i monitorimit		
Element i monitorimit	Frekuenca	Pergjegjesi
Sasia e ujit ne lum para marrjes se tij dhe devijimit per ne HEC	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Sasia e ujit ne lum pas marrjes se tij dhe devijimit per ne HEC	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Sasia e ujit ne lum pas shkarkimit nga HEC-i (ne vazhdim te rrjedhes natyrale)	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Sasia e ujit qe do te perdoret nge HEC-i	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Parametrat fiziko-kimike te ujit te perdorur para marrjes dhe futjes ne turbina	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Analize e plote: parametrat fizike, temperatura, pH, llumrat dhe lenda e		



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

ngurte etj		
Parametrat fiziko-kimike te ujit te perdonur pas shkarkimit ne lum	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Gjendja e flores dhe faunes ne zonen ne afersi te veprave inxhinierike	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Niveli i zhurmes ne afersi te godines se HEC-it	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Sasia e karburantit te harxhuar gjate fazes ndertimore deri ne mbarim te ndertimit te HEC-it	Periodike	Kompania Shfrytezuese
Matja e nivelist te rrezatimit perreth objekteve prane linjave te transmisionit	Periodike	Kompania Shfrytezuese

Tabela 5: Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis te aktivitetit

➤ KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME


Analiza e kryer ne kete raport ne lidhje me ndikimet e mundshme ne mjedis te projektit tregon se ndikimet ne fazen e ndertimit te vepres jane te perkohshme, ndersa ato te fazes operacionale jane te perhershime. Por, per te dyja llojet e ndikimeve, ekzistojne mundesi reale per kontrollin dhe minimizimin e tyre ne terma te pranueshem. Vlen te theksohet se projektet e prodhimit te energjise me ane te HEC-eve, te cilet perdonin burime te rinnovueshme, jane ne listen e rekmandimeve dhe prioriteteve te politikave mjedisore sot ne rrafshin global pasi energjia e prodhuar ne kete menyre quhet ndryshe energji e paster.

KONKLUZIONE

1. Studimi i kryer per te plotesuar kerkesat qe parashtron nje VNM ka ndjekur standartet e vendit dhe nderkombetare.Ndikimet pozitive apo negative te projektit te propozuar jane identifikuar dhe llogaritur ne shkallen e mundur te arsyeshme.
2. Projekti qe eshte paraqitur, gjate hartimit te tij, ka marre parasysh respektimin e kritereve mjedisore.
3. Projekti nuk cenon zona te mbrojtura dhe monumente natyrore.
4. Ekzistojne te gjitha mundesite teknike per marrjen e masave per mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit ujor te lumbit te Zallit te Bulqizes.
5. Punimet e ndertimit te veprave do te behen me pajisje te teknologjise me te avancuar te fushes dhe do te garantojne siguri ne pune dhe ndikim minimal ne mjedisin perreth.
6. Ndërtimi i hidrocentralit “Cerenec” jep një kontribut ekonomik për Rrethin e Bulqizes si dhe një kontribut social – ekonomik për banorët e fshatit Gjorce e Eperme , duke ju krijuar kushte punësimi.
7. Ndërtimi i hidrocentralit “Cerenec” jep një ndihmesë të madhe për përmirësimin e humbjeve fizike për rrjetin shpërndarës të energjisë ne Rrethin Bulqize.

REKOMANDIME

1. Te monitorohet ne vazhdimesi kontrolli i rrjedhes ekologjike per sasine e projektuar te saj.
2. Te percaktohet, ne bashkepunim me autoritetet vendore, vendet e mundshme te depozitimit te mbeturinave inerte te gjeneruara gjate fazes ndertimore.



3. Te percaktohet, ne bashkepunim me autoritetet perkatese, se cila do te jetë menyra e trajtimit perfundimtar te dheut te ndotur si pasoje e rrjedhjeve te pakontrolluara.
 4. Boja e perdorur per lyerje (me qellim mbrojtjen nga ndryshku) te kete ngjyre te pershtatshme, qe te gershetohet natyrshem me mjedisin, por edhe perberje kimike te parrezikshme per te.
 5. Ne anet e rrugeve ekzistuese dhe ato te sherbimit te shihet mundesa e mbjelljes se disa pemeve, si mase rehabilituese ekologjike.
 6. Te behet trajnimi periodik i punonjesve por edhe i nenkontraktoreve te tij, me qellim njohjen e tyre te vazhdueshme me praktikat me te mira te ruajtjes se mjedisit.
 7. Te bashkepunohet me organet e qeverisjes lokale per mbrojtjen e mbuleses vegetative, pyje, kullota nga keqperdorimi, prerjet e paligjshme, mbikullotja, zjarret etj.
 8. Një vëmëndje të veçantë i duhet kushtuar kërkesave për cilësinë e paisjeve, si dhe instalimit të mjeteve të M.N.Z-së.
 9. Zbatimi korrekt i masave për ruajtjen e përmirësimin e mjedisit të zonës rrëth objektit, do të ndikoje pozitivisht në pejsazhin e zonës.
- 9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË)**

Zona e projektit ndodhet ne një largesi te konsiderueshme nga kufiri me vendet fqinje keshtu qe, projekt nuk do te kete ndikim ne mjedisin nderkufitar. Ky projekt nuk eshte e nevojshme ti nenshtrohet vleresimit te ndikimit ne mjedis ne kontekstin nderkufitar.



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

10. CERTIFIKATËN DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKL-SË, TË SPECIALISTIT QË KA HARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



Nr.licenca: K516370401
LN-7575-03-2014
Subjecti: "TAULANT" Shpk
Adresa: Tiranë, TIRANE, TIRANE, Rruga Ferid Xhafo, Pallati 60/4,
Shkalla 1, Ap. 3
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e rëshimit: 04/03/2014
Kod ijetar:
Atati vlefshme: Pa afat

Emissimi përsikues, veprintribësi

Veprimtarie e ekspertitës lidhur me ndikimin në mjedis. (auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)

Nr.licenca: K516370401
LN-7575-03-2014
Subjecti: "TAULANT" Shpk
Adresa: Tiranë, TIRANE, TIRANE, Rruga Ferid Xhafo, Pallati 60/4,
Shkalla 1, Ap. 3
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e rëshimit: 04/03/2014
Kod ijetar:
Atati vlefshme: Pa afat

Kufitare specifike

Licencia u shtrrohet sipas kufizimeve ne legjislacionin ne fuqi

Nr.licenca: K516370401
LN-7575-03-2014
Subjecti: "TAULANT" Shpk
Adresa: Tiranë, TIRANE, TIRANE, Rruga Ferid Xhafo, Pallati 60/4,
Shkalla 1, Ap. 3
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e rëshimit: 04/03/2014
Kod ijetar:
Atati vlefshme: Pa afat

Detyrime specifike

Licencia u shtrrohet sipas detyrimave ne legjislacionin ne fuqi

Nr.licenca: K516370401
LN-7575-03-2014
Subjecti: "TAULANT" Shpk
Adresa: Tiranë, TIRANE, TIRANE, Rruga Ferid Xhafo, Pallati 60/4,
Shkalla 1, Ap. 3
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e rëshimit: 04/03/2014
Kod ijetar:
Atati vlefshme: Pa afat


Vendi i kryerjes se veprimitarit

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Nr.licenca: K516370401
LN-7575-03-2014
Subjecti: "TAULANT" Shpk
Adresa: Tiranë, TIRANE, TIRANE, Rruga Ferid Xhafo, Pallati 60/4,
Shkalla 1, Ap. 3
Kodi: III.2.A (1+2)
Data e rëshimit: 04/03/2014
Kod ijetar:
Atati vlefshme: Pa afat

Vendi i kryerjes se veprimitarit

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJERAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruja "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 627 - www.mos.gov.al

Nr. 50/3 Prot.

Tiranë, më 04.08.2013

Nr. identifikues 98

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për
pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor":

Znj. DITIKA QATIPI

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI
[Signature]
Fatmir MEDUROV





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJÉRAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore

Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Reshtra "Durrësi" Nr. 27 Tiranë Tel. 01 2256 113 Fax. 01 2270 627 - www.mee.gov.al

Nr. 5012 Prot.

Tiranë, më 04.02.2013

Nr. identifikues 97

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr.1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për
pajujen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor";

Znj. ERJONA QATIPI

Çertifikabet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDIU



Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Hec CERENEC

<i>LITERATURA:</i>	<i>AUTORI</i>	<i>VITI BOT</i>
1) Klasifikimi i tokave te Shqiperise	K.Cara; F.Gjoka	2003
2) Hartografimi gjeologo-ambiental	J. Hoxha	2000
3) Buletini mjedisor	A.K.M	1999, 2000
4) Harta e klasifikimit te tokave te Shqipërisë	Grup autorësh	2003
5) Hidrologja e Shqipërisë	HMI	1984
6) Raport mbi gjendjen e mjedisit ne Shqipëri	Grup autorësh	2004
7) Plani Kombëtar i Veprimit ne Mjedis		
8) Gjeografia fizike e Shqipërisë (Vëll 1 & 2)	F. Krutaj	1991
9) Hidrogjeologja	Xh. Xhemalaj	1997
10) Ekologja	N. Peja;	1999
11) Ekologja dhe ekosistemet e saj	V.Peculi; A.Kopali	2006
12) Web site te ndryshme.		

SHTOJCA 1 : Bashkengjitur Raportit eshte vendosur :

- Planvendosja e pergjithshme e veprave te Hec Cerenec dhe siperfaqet e depozitimit te inerteve.

- Grafiku i Punimeve

PERGATITUR NGA:

“TAULANT” sh.p.k.
QKL, LN-7574-03-2014
Eksperte mjedisi:
Ditika Qatipi
Erjona Qatipi

POROSITESI:

“RAJFI” shpk




Bashkepunim me, “EBS” sh.p.k.
Ing.Hidroteknik Fahri MAHQ
Msc. Ing. Mjedisi Nelisa HAXHI



Tiranë, 2018

PLANIMETRIA E PERGJITHSHME E VENDOSJES
SE VEPRAVE TE HEC-CERENEC DHE VENDDEPOZITIMET E INERTEVE
SH. 1:2500



TIRANE 2018		HIDRO ELEKTRO CENTRALI "CERENEC" QARKU DIBER	NRI I FLETËS -PP-01
E Consulting	B Contracting	ING. HIDROTEKNIK FAHRI MAHO Z.0673/3	
S Company		ING. HIDROTEKNIK JURGEN OCCELLI	
		ING. HIDROTEKNIK TAULANT QEJANI P.K.	
		ING. HIDROTEKNIK SILVIA GJONAJ TIRANA - ALBANIA	
		ING. MJEĐISI NELISA HAZHI	
		SHK. 1:2500 ING. GJEODET JULIAN GJOKA	

Emertimi HEC-it	Nr.	Pershkrimi i Punimeve	GRAFIKU I PUNIMEVE NE HIDROCENTRALIN "CERENEC"																					
			PERIUDHA E NDERTIMIT (21 MUAJ)																					
			Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8	Muaji 9	Muaji 10	Muaji 11	Muaji 12	Muaji 13	Muaji 14	Muaji 15	Muaji 16	Muaji 17	Muaji 18	Muaji 19	Muaji 20	Muaji 21	
HEC CERENEC	1	Ndërtim Rrugësh	1	2	1	2																		
	2	Ngritje Kantieri	1	2																				
	3	Vepra e Marrjes			1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	
	5	Basen Presioni																						
	8	Boks Derivimi																						
	9	Kulla e ekuilibrit																						
	11	Ndërtesa e Centralit																						
	12	Instalime Elektro-Mekanike																						
	13	Lidhja me Sist. Energjistik																						
	14	Testet dhe Kolaudimi i Veprës																						
PER KOMPANIINE KONSULENTE "E.B.S" Shpk																								
Fahri MAHO																								
																								
PER KOMPANIINE "RAJFI" sh.p.k																								
Ramadan GUGASHI																								
																								

